



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

**Raport Përfundimtar Auditimi Tematik të ushtruar në
"Bashkinë Kuçovë"**

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN TEMETIK

"BASHKIA KUÇOVË"

**(Auditim Financiar, mbi pasqyrat
financiare 2020)**

Tiranë, 2021

PËRMBAJTJA:

NR	EMËRTIMI I KAPITUJVE	FAQE
I	PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	4 - 9
I.2	Konkluzioni dhe Opinioni Auditimit	9 - 10
II	HYRJA	11 - 15
	a. Titulli. b. Marrësi. c. Objektivat dhe qëllimi. d. Identifikimi i çështjes. e. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese. f. Përgjegjësitë e Audituesve. g. Kriteret e vlerësimit. h. Standardet e auditimit. i. Metodat e auditimi. j. Dokumenti i auditimit.	
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	15 - 37
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.	15 - 16
2.	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.	16 - 37
2/A.	<i>A-Vlerësimi Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitet 2019-2020, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, ligjin nr. 24/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe UMFE nr.08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”.</i>	
IV.	GJETJE DHE REKOMANDIMI	37 - 42

SHKURTIME

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit.
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.
NA	Nëpunës Autorizues.
NZ	Nëpunës Zbatues.
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik.
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave.
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak.
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
IFAC	Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
IT	Teknologjia e Informacionit.
NJA	Njësi Administrative.

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në përputhje me objektin e auditimit, u auditua me zgjedhje mbi bazë materialiteti dhe risku, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, monitorimi i tyre nga Auditimi i Brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit për të ardhurat dhe shpenzimet, mbajtja e kontabilitetit dhe hartimi i pasqyrave financiare, aplikimi i rregullave kontabël si dhe nëse transaksionet financiare janë në përputhje me kërkesat ligjore, rregullat e institucionit dhe parimet, për një qeverisje të mirë dhe transparente, në përmbushje të objektivave të institucionit Bashkia Kuçovë.

Për këto u analizuan pyetësorët e vetëvlerësimit, akt akordimet me thesarin duke shkarkuar transaksione financiare nga SIFQ¹, u krye analiza e posteve të bilancit dhe llogarive analitike me formatet shoqëruese të tyre duke prekur zonat e llogarive, si më poshtë:

Llogaria 520 “Disponibilitete në Thesar”; Llogaria 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje”; Llogaritë 230 dhe 231 “Investime...”; Llogaritë 202, 210, 211, 212, 213, 214, 215, 218, 31, 32, “Aktiveve të Qëndrueshme, Qarkulluese dhe të tjera Aktive”; Llogaria 202 “Studime dhe kërkime”; Llogaria 210 “Toka, troje, terrene”; Llogaria 211 “Pyje kullota plantacione”; Llogaria 212 “Ndërtesa e konstruksione”; Llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”; Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri paisje, vegla pune”; Llogaria 215 “Mjete transporti”; Llogaria 218 “Inventar ekonomik”; Llogaritë e Klasës 25/26 “Aktivet Afatgjata Financiare”; Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”; Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”; Llogaria 4342 “Operacione me shtetin”; Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”; Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”; Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit”; Llogaria 431 “Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksat”; Llogaria “435 “Sigurime Shoqërore”; Llogaria “436 “Sigurimet shëndetësore”; llogaritja dhe paraqitja e amortizimit, etj. 600 “Paga”, 602 “Shpenzime operative” dhe 230-231 “Investime”.

- Nga auditimi i pasqyrave financiare (balance) të viti 2020, grupi i auditimit të KLSH, pas vlerësimit të dokumentacionit, arrin në konkluzionin për një “*Opinion i modifikuar*”, pasi disa nga llogaritë nuk paraqesin drejt në të gjitha aspektet materiale, pozicionin e llogarive në fund të periudhave ushtrimore, performancës financiare dhe fluksin e parasë në përputhje me kuadrin e Raportimit Financiar të Sektorit Publik.

I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca në Raport	Rekomandimi
1	Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2020, u konstatua se Të dhënat në tabelë përmbledhëse të inventarizimit janë konstatuar, diferenca në administrimin e aktiveve, ndërmjet gjendjes fizike të inventarit fizik dhe gjendjes kontabël vlera historike e deklaruar në pasqyrat financiare, me diferenca në (<i>mungesë</i>) në gjendjen fizike sipas fletë inventarit ku; llog.(32) shuma 269,862 lekë , e cila përfaqëson libra dhe nga komisione sipas PV datë	E lartë		9.1. Rekomandimi: Bashkia Kuçovë, nëpërmjet Nënpunësit Zbatues të marrë masa për sistemin llog. 327, për diferencat e konstatuara sipas inventarë të kryer për vitin 2020, si dhe të ndjek të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës 269,862 lekë ndajë z. E.M., si personi përgjegjës për diferencën e konstatuar ndërmjet fizikut dhe kontablit. 9.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kuçovë, në cilësinë e

¹ Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca në Raport	Rekomandimi
	29.01.2021 janë nxjerre përgjegjësi dhe ngarkuar për shpërbllim dëmi personin përgjegjës z. E.M., sipas njoftim detyrimit nr. 487, datë 8.2.2021, por që akoma nuk është zhveshur nga vlera kontabël e llog. 327, e cila lihet detyrë për pasqyrat financiare të vitit 2021, veprime në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu (IV) “Sistemi kontrollit periodik aktive”, pika 74 “Inventarizimi aktive”.			Nëpunësit Autorizues në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë e Financë/ Buxhet në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, të marrin masa për zhvillimin e procedurave të ankandit për shitjen e materialeve të dala jashtë përdorimit, por të vlerësuara nga komisioni për rishitje.
2.	Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2020, u konstatua se llogaria (466) “Kreditorë për mjete në ruajtje”, paraqitet vlera prej 15,882,787 lekë, e cila përfaqëson detyrimet që Bashkia Kuçovë ka ndaj subjekteve të ndryshme për garanci punimesh (5%), deri më 31.12.2020. Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se vlera prej 10,390,115 lekë për 13 subjekte, nuk u ka përfunduar afati i garancisë së punimeve. Ndërsa vlera prej 5,492,672 lekë për 19 subjekte, përfaqëson detyrime të bashkisë ndaj subjekteve, për garanci punimesh të kryera para vitit 2019, të cilave ju ka përfunduar afati i garancisë së punimeve (të dhëna sipas pasqyrës Aneks 1, bashkëlidhur raport auditimit). Nga ana e Bashkisë Kuçovë, Drejtoria e Financës nuk është marrë asnjë masë për sistemin e kësaj llogarie për rastet ku afati i garancisë së punimeve ka përfunduar, veprime në kundërshtim me ligji nr. 68, datë 24.7.2017 “Për financat e Qeverisjes Vendore” dhe Udhëzimi nr. 8, datë 9.3.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të qeverisjes së përgjithshme”.	E lartë		Drejtorja e Financë/Buxhet Bashkia Kuçovë, të marrin masa për sistemimin e llogarisë (466) “Kreditorë për mjete në ruajtje”, për rastet kur garancia e punimeve ka përfunduar, duke bërë njoftimin e subjekteve për paraqitjen e dokumentacionit përkatës për kalimin e garancive, ose në rast mos paraqitje në bashkëpunim me Degën e Thesarit të shfrytëzohen të gjitha hapësirat ligjore për sistemin e kësaj llogari.
3.	Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2020, u konstatua se llogaria. (468)	E lartë		Drejtorja e Financë/Buxhet në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Drejtorinë e Taksave Vendore dhe

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca në Raport	Rekomandimi
	“Debitorë të ndryshëm” e cila paraqitet në vlerën 167,809,137 lekë. Në lidhje me detyrimet debitorë të mësipërme, Drejtoria e Financës me shkresën përcjellëse nr. 3549, datë 17.10.2018 i është drejtuar Drejtorisë Juridike për ndjekjen e procedurave në arkëtimin e tyre, por nga kjo e fundit nuk është vepruar duke i lënë në heshtje dhe rënduar ndër vite llogarinë, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” nenet 98-102, ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 21-33 dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 93.			Inspektoratin Vendore Mbrojtjes Territorit (IVMT), të marrin masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e detyrimeve debitorë në vlerën 167,809,137 lekë, të paraqitura në fund të periudhës 31.12.2020, kjo për të ulur nivelin e borxhit dhe rritur nivelin e të ardhurave të Bashkisë Kuçovë.
4.	Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2020, u konstatua se llogaria (202), e cila paraqitet në shumën 17,152,484 lekë. Nga të dhënat e investimeve, në totalin e llog 202- <i>Studime dhe kërkime</i>, nga 7 projekte që janë në këtë llogari ka përfunduar vetëm për një objekt, konkretisht “<i>Projekti për rikonstruksionin e rrugës "Ura Vajgurore-Kuçovë"</i>”. Nga Drejtoria e Financës nuk janë bërë përpjekje për sistemin e veprimit kontabël të llogarisë, duke ia bashkëngjitur vlerës së projektit. Sipas Drejt. Financës një veprim i tillë nuk është kryer pasi ky segment rrugorë nuk është aset i Bashkisë Kuçovë, por i Autoritetit Rrugorë Shqiptar, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” dhe UKM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, shkronja (b).	E lartë		Drejtoria e Financës të marrë masa për sistemimin e llogarisë (202) “<i>Studime dhe kërkime</i>”, duke bërë që në këtë llogari të paraqitet vetëm vlera e projekteve, për të cilat investimet e lidhura me to nuk kanë përfunduar. Për projektet të cilat kanë përfunduar, vlerat të kapitalizohet sipas objekteve përkatëse dhe regjistrohen në llogaritë përkatësisë, si pjesë e kostos totale të objektit.

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca në Raport	Rekomandimi
5.	Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2020, u konstatua se llogaria (26) “Aktive afatgjata Financiare”, paraqitet me vlerë zero, vlerë e cila nuk qëndron, kjo pasi Bashkia Kuçovë në QKB paraqet aksione me 100% të Klubit të Futbollit “N...” me Nipt , e cila është aksionare me objekt “ <i>Organizim i aktivitetit sportiv në fushën e futbollit</i> ”. Regjistri si klub në federatën Shqiptare të futbollit dhe në të gjitha llojet e aktiviteteve të futbollit”. Bashkia Kuçovë është aksionere me vlerë 3,500,000 lekë. Kjo vlerë e kapitalit me 100% lekë/aksione pjesëmarrës të Bashkisë Kuçovë në “F...” sha, në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të pasqyrave financiare viti 2020, më konkretisht në llogarinë (26) “Aktive afatgjata materiale”, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Urdhrin e MF nr. 64, datë 22.7.2014 “Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabiliteti të Përmisuar”, me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit nr. 5 “Aktivet afatgjata Materiale dhe Aktivet afatgjata Jo materiale”, pika 55,56 dhe 57.	E lartë		Bashkia Kuçovë, nëpërmjet Nënpunësit Zbatues të marrë masa për sistemimin në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin e aksioneve tek KF “N...” me vlerë 3,500,000 lekë, në debi të llog. 26 “ <i>Pjesëmarrje në kapitalet e veta</i> ” dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.
6	Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2020, u konstatua se nga përpunimi i të dhënave mbi llog (231), e cila paraqitet në shumën 129,876,824 lekë, u konstatua se për disa objekte megjithëse kanë përfunduar, nuk është bërë sistemi i tyre nga llog (231) në llogarinë (212), pasi objektet kanë përfunduar, konkretisht: Nuk janë kryer veprime kontabël për sistemin llogarish nga llog (231) në llog (212), kjo për objektin “ <i>Rruga Perondi – Lapardha faza I</i> ”, objekti “ <i>Rruga Perondi – Goraj</i> ” dhe objekti “ <i>Rikonstruksion me rërë bituminoze</i> ” Gjithashtu evidentohet fakti se llogaria (467) “ <i>Kreditor të ndryshëm</i> ”, sipas analizës së bërë për disa nga objektet vlera e faturës kreditorë më 31.12.2020, kemi mos përputhje me faturës kreditore	E lartë		Bashkia Kuçovë, nëpërmjet Nënpunësit Zbatues të marrë masa për: - Sistemin në kontabilitet të llogarisë (231) në llogaritë (213) ose (213), sipas objekteve pasi një pjesë e tyre janë mbyllur dhe duhet të kapitalizohet në aktive afatgjata materiale. - Të sistemohen diferencat e faturave gjendje në fund të vitit 2020 në llogarinë 467, për një paraqitje të saktë të faturave të palikujduara në fund të periudhave ushtrimore, kjo për shumën 3,967,858 lekë në objektin “ <i>Permiresim I banesave kom.varfera</i> ” . - Të marrë masa për planifikimin e procedurave në raport me nivelin e të ardhurave të arkëtuara në fakt dhe fondeve të deleguara dhe të mos planifikohet procedura të tjera pa mundësuar likuidimin e detyrimeve të

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca në Raport	Rekomandimi
	të paraqitur në fund të vitit me vlerë reale që duhet të ishte, <i>konkretisht</i>: - Objekti “<i>Permiresim I banesave kom.varfera</i>”, me vlerë kontrate 27,709,197 lekë. Likuiduar deri datë 31.12.2020 shumë 22,667,357 lekë dhe diferenca pa likuiduar akoma për mungesë fondesh në shumën 5,041,840 lekë. Sipas analizës së pasqyrës së kreditorëve, ky objektet paraqitet për vlerën 1,073,982 lekë, pra me një diferencë më pak sipas analizës për vlerën 3,967,858 lekë. Nga auditimi u konstatua se detyrimet e raportuara në fund të vitit 2020 në vlerën 155,086,764 lekë (<i>të akumuluar</i>) dhe fondet e miratuara për shpenzime të këtij viti në vlerën 727,616,364 lekë. Kjo situatë tregon se Bashkia Kuçovë mund të konsiderohet me probleme financiare në fund të vitit ushtrimor 2020, pasi vlera e stokut të detyrimeve të papaguara ndaj palëve të treta është 21.3 %, pra mbi nivelin prej 15 % të shpenzimeve vjetore të miratuara. Nëse situata nuk një përmisim, bashkia mund të kalojë dhe në vështirësi financiare, ku stoku i detyrimeve të prapambetura mund të kalojë 25% e shpenzimeve vjetore të miratuara, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” dhe UKM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe neneve 55 dhe 56, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.			prapambetura, kjo për të shmangur fenomenin e rritjes së faturave të palikujduara në fund të periudhës ushtrimore si rezultat i mos realizmit të të ardhurave dhe për të shmangur problemet financiare që kjo njësi ka dhe vështirësinë financiare që pritet të futet, pasi stoku i detyrimeve të prapambetura mund të kalojë 25% e shpenzimeve vjetore të miratuara.
7	Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2020, u konstatua se nga 294 objekte inventari në ndërtesa e konstruksione të administruara llog.(212) pasuri e paluajtshme (<i>sasi e vlerë</i>) pjesa e konsiderueshme e tyre prej 251 prona	E lartë		Titullari i Bashkisë Kuçovë, nëpërmjet Sektorit të Aseteve pranë Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (DPZHT), të marrë masa që të përgatisë dosjet me dokumentacionin e nevojshëm për regjistrimin e pasurive

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca në Raport	Rekomandimi
	(<i>trajtuar analitikisht</i>) nuk janë të regjistruara në kontabilitet dhe pasqyrat financiare në aktiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, pasi 206 objekte janë të trashëguara nga (<i>ish/komunat</i>) NJSH, ndërsa 45 objekte të trashëguara nga ish/Bashkia, të mbartura nga periudhat raportuese paraardhëse (viti 2015), sipas gjendjes kontabël dhe inventar, për të cilat nuk posedohet asnjë titull pronësie (<i>certifikatë, apo vërtetim</i>). Gjithashtu, sipas të dhënave të Sektorit të Aseteve pranë Drejtorisë së PZHT, u konstatua se një pjesë e pronave janë regjistruar nga Bashkia Kuçovë në Drejtorinë rajonale të ASHK Kuçovë, por pa vlerë. Kështu gjithsej janë regjistruar 210 prona por pa vlerë, gjë e cila vështirëson procesin e kontabilizimit në pasqyrat financiare si asetet të Bashkisë Kuçovë. Për rrjedhojë kontabilizimi i AAM, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur, veprime në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu (VI) “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme” dhe veprim në mospërputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me ndryshime, Kreu (III), pika 35 dhe Kreu (II), pika (16).			të peregjistruara në Drejtorinë Rajonale ASHK Kuçovë të pasurive të peregjistruara, ndërsa Drejtoria e Financës të përllogarisë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimit, burimet e financimit me qëllim marrjen sa më parë të titujve të pronësisë të pasurive të paluajtshme. Kryetari i Bashkisë Kuçovë në cilësinë e Nënpunësit Autorizuar në bashkëpunim me Drejtorin e Financës në cilësinë e Nënpunësit Zbatues, të ndërmarr të gjitha procedurat ligjore për vlerësimin e aktiveve të cilat janë pjesë e inventarit AAGJ të bashkisë, të certifikuara në ASHK Kuçovë, por pa vlerë respektive, me qëllim paraqitjen e vlerës së këtyre aktiveve në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të njësisë publike vendore bashkia Kuçovë më 31.12.2021.
8	Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2020, u konstatua se vlera e AAM/JM të paraqitura në Pasqyrat e Pozicionit Financiar, nuk evidentojnë “<i>vlerën reale</i>” të tyre, pasi nga ana e Bashkisë Kuçovë nuk është ndërmarrë asnjë procedurë rivlerësimi ndaj tyre, bazuar në SKK (5) “Aktive afatgjata materiale e aktive jo materiale”, paragrafi “Trajtimet kontabël për aktive afatgjata materiale”, pika (23-32) “Modeli rivlerësimi”. Vlerat fillestare, apo kostot historike të këtyre aktiveve	E lartë		Titullari i Bashkisë Kuçovë në cilësinë e Nënpunësit Autorizues, të marrë masa të menjëhershme për të kryer procedurat ligjore të rivlerësimit të aktiveve afatgjata materiale (<i>ndërtesa e konstruksione</i>), pasqyrimin e tyre në kontabilitet me vlerë reale historike (<i>referuar tregut</i>), si dhe kryerjen e veprimeve kontabël referuar rezultatit (<i>rritje/ulje rivlerësimi</i>), respektivisht në llogaritë përkatëse (21) “Aktive afatgjata materiale” e llog.(109) “Diferenca nga rivlerësimi”.

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca në Raport	Rekomandimi
	rezultojnë sipas çmimeve të blerjes, si dhe kosto të tjera të drejtpërdrejta në periudhat përkatëse të krijimit, të cilat referuar në gjendjen që pasqyron kontabiliteti llog.(212) “Ndërtesa e konstruksione” për 251 (294-43) objekte (ndërtesa e konstruksione të ndryshme, etj) me vlerë 0 (zero) lekë e cila ka sjellë një situatë që vlera e aktiveve të nënvlerësohet, në lidhje me vlerësimin e aktiveve. Gjithashtu për asnjë nga periudhat që nga momenti i bashkimit të ish komunave në një bashki, nuk është kryer inventarizimi i asteve që Bashkia Kuçovë ka të regjistruara në pasqyrat financiare, gjë e cila bëhet me evidente nga bashkia me ish komunat dhe nuk dihet me saktë si gjendje fizike e tyre, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar , Kapitulli IV-Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, "Inventarizimi i aktiveve". UMF nr. 08, datë 09.03.2018: Kap.(IV) “Përgatitja dhe rregullat e plotësimit të pasqyrave financiare vjetore të konsoliduar”, pika (105).			Të ngrejë një grup pune me specialit të fushës, për kryerjen e inventarizimit të asteve të Bashkisë Kuçovë, të paraqitura në pasqyrat financiare, mbi evidentimin e gjendjes së tyre në fakt dhe në rast mungesë të ndiqen procedurat ligjore për sistemin dhe nxjerrje përgjegjësie.

I.2. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit

Opinion i auditimit mbi pasqyrat financiare

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Kuçovë, për vitin ushtrimor 2020, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinion i modifikuar:

Sipas opinionit tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një opinion të kualifikuar për llogaritë vjetore të subjektit Bashkia Kuçovë, duke arritur në përfundimin se anomali apo rastet e mospërputhshmërisë,

individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura, në llogaritë vjetore të vitit 2020.

Baza për opinionin i modifikuar:

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona, sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit, ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare.

Theksojmë nevojën e marrjes së masave nga ana e drejtimit e më pas në linjë hierarkike nga gjithë personeli i subjektit Bashkia Kuçovë, sa më poshtë vijon:

- Mos hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduar me gjithë njësitë vartëse.
- Mos sistemi i llog 466, për garancitë e punimeve (5%), të objekteve të përfunduara dhe që ju ka përfunduar afati i likuidimit të garancive.
- Mos ndjekja e hapave ligjore në arkëtimin e debitorëve paraqitur me vlerë 167,809 mijë lekë dhe pastrimi i llogarisë.
- Sistemi i llog. 202 “Studime dhe kërkime”, për projektet e përfunduara dhe marra në dorëzim, duke kryer kapitalizmin e tyre në vlerën e investimit.
- Mos sistemi i llog 26 “aktive afatgjata financiare”, për vlerën e kapitali të depozituar në KF “N...”, me 100% të aksioneve;
- Pasaktësi në evidentuar në llog 467 “Kreditorë të ndryshëm”, ku një pjesë e faturave nuk paraqitet për vlerën reale të detyrimit që Bashkia Kuçovë ka ndaj subjekteve;
- Mos sistemi i llog. 231 e cila paraqitet në vlerën 129,876,824 lekë në llogaritë 212 ose llog. 213, për objektet e përfunduara dhe marra në dorëzim.
- -Llog. (211) “Ndërtime e Konstruksione” nuk paraqet gjendjen reale sepse, nuk disponohet asnjë lloj dokument pronësie për 206 objekte të trashëguara nga (ish/komunat)
- -Llog. (327) “Inventar i imët” nuk paraqet gjendjen reale sepse, nga procesi i inventarizimit të gjendjes fizike, kanë rezultuar diferenca në mungesë shuma 269,862 lekë, të pa sistemuara nga Drejtoria e Financës në periudhën raportuese ushtrimore paraardhëse, për të cilat kërkohet sistemimi i menjëhershëm në llogari përkatëse me kalim në debitor për mungesat dhe hyrje në administrim për tepricat.
-

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Kuçovë:

Strukturat drejtuese të Bashkisë Kuçovë, janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (*kriteret e vlerësimit*). Ato janë përgjegjëse për zbatimin e gjithë kuadrit regullativ në prokurimin e fondeve publike. Gjithashtu, strukturat drejtuese të Bashkisë Kuçovë janë përgjegjëse funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së:

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH-së, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale duke i përshkruar në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri

ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. HYRJA

II/1. PËRSHKRIM I AUDITIMIT.

Mbështetur në ligjin nr.154/14, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 678, datë 14.6.2021 dhe autorizimit nr. 678/4, datë 14.6.2021 “Mbi auditimin e pasqyrave financiare viti 2020”, të miratuara nga Kryetari i KLSH, nga data 14.6.2021 – 2.7.2021, në subjektin Bashkia Kuçovë për periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2020 – 31.12.2020, u krye auditimi “Auditim Financiar mbi pasqyrat financiare viti 2020”, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. **K.GJ.,** *Përgjegjës Grupi*
2. **J.P.,** *Auditues*

a- Titulli: Auditim financiar në Bashkinë Kuçovë.

b- Marrësi: Raporti i Auditimit Tematik i drejtohet subjekti të audituar Bashkinë Kuçovë.

c- Objektivat dhe qëllimi: Objektivi i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2020, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është të rrisim shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë financiare.

Kjo përgjegjshmëri ka të bëjë drejtpërdrejt me menaxhimin e shëndoshë financiar si dhe me faktin që, rezultatet e përdorimit i burimeve janë të paraqitura drejt dhe në përputhshmëri me kornizën e raportimit financiar. Audituesit shtetërorë do të japin sigurinë ose jo nëse informacioni i paraqitur mbi shpenzimin e parave publike në programet publike përfaqëson në mënyrë të përshtatshme situatën financiare.

d- Identifikimi i çështjes: Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundur kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t’i shërbej subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Raporti i Auditimit, synon të identifikojë përmbyshjen e rolit të njësive vendore dhe përgjegjëseve të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Kuçovë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykitimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe

është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit.

e- Përgjegjësitë e strukturave drejtuese: Administratori i Përgjithshëm, në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) **K.H.** me funksion Kryetar i Bashkisë Kuçovë dhe Drejtore e Financës, në cilësisë e Nëpunësit Zbatues (NZ) **H.SH.**, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Gjithashtu, në cilësinë edhe të NA si dhe NZ, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Kuçovë, bazuar në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, konkretisht neni 34, pika 6², neni 65, pika 1³ dhe neni 91, pika 1.3⁴.

f- Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së: Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare Bashkisë Kuçovë dhe një opinion në lidhje me përputhshmërinë e aktivitetit të subjektit të audituar në lidhje me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, prokurimin dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së mbledhur të auditimit.

Parimet e auditimit financiar: Në punën tonë audituese jemi mbështetur në parimet e mëposhtme:

- *Etika dhe pavarësia;*
- *Kontrolli i cilësisë*
- *Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre*
- *Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.*

Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim:

- *Përkatësia:* Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.
- *Plotësia:* Te gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar
- *Saktësia:* Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme
- *Periudha:* Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël
- *Klasifikimi:* Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura
- *Ligjshmëria dhe rregullsia:* Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion

Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës.

- *Ekzistenca:* asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto ekzistojnë

² “Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore harton, miraton, zbaton dhe administron çdo vit buxhetin e vet, pa deficit, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon administrimin e zbatimin e sistemit buxhetor dhe ligjin për financat vendore”

³ “Në njësitë administrative funksionon administrata që drejtohet nga administratori”.

⁴ “Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi:

a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre;

b) vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre;

ç) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit”.

- Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet, detyrimet dhe janë obligimet e subjektit
- *Plotësia*: Të gjitha asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar
- *Vlerësimi dhe alokimi*: Aktivitet, pasivet dhe interesat e kapitali janë të përfshira në pasqyrat financiare dhe shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese.

- *Transaksionet*, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e shpalosura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.
- *Plotësia*: Te gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.
- *Klasifikimi dhe kuptueshmëria*: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe të përshkruara dhe shënimet e kanë shprehur qartë.
- *Saktësia dhe vlerësimi*: Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur.

g- Kriteret e vlerësimit: Auditimi u bazua në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 196, datë 29.12.15, referenca të tjera ligjore dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit sa më poshtë:

■ ***Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit Pasqyrave Financiare:***
Ligji nr. 9228, datë 24.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, i ndryshuar ligjin nr. 9477 datë 9.2.2006”, aktualisht i shfuqizuar; VKM nr. 248, datë 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njërive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”; Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme”; Udhëzimi përbashkët i Ministrisë të Çështjeve Vendore dhe Ministrisë Financiare nr. 3237 datë 16.07.2015 “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”.

h- Standardet e auditimit: ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”; ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”; INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontroleve të brendshëm”. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, etj.; Kodit Etik dhe Rregullores së Procedurave të Auditimit të KLSH.

i- Metodatat e auditimit: Auditim i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të

auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të Audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin⁵.

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerësojnë si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, u përdorën teknikat e auditimit:

- Kontrolli aritmetik. Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)
- Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese. Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.
- Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese. Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përpunimin ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.
- Kontrolli i vlerësimit. Kontrolli i vlerësimeve përcaktonte nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.
- Konfirmim nga të tretët. Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepërësive ose të çdo regjistrimi tjetër.
- Kontrolli sipas një treguesi. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsisë kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.
- **Intervista**
- **Raporte dhe Informacione**
- **Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm dhe MFK**

j- Dokumentimi i auditimit: Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin

⁵ ISSAI 1320 (ISA 320) trajton përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të përdoret edhe në rastet e auditimit të përpunshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.

e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale.

Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për llogaritjen e tij janë marrë shpenzimet për pagat (600), shpenzimet operative (602) dhe investimet (231). Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5 komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm është bazuar në kryerjen e testeve të kontrolleve. Gjatë kryerjes së testeve të kontrolleve është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit, konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke iu nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e Audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që aplikon KLSH-ja⁶.

Procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në analizat e marrëdhënieve ndërmjet



informacionit financiar dhe jo financiar; inspektimeve që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ditarë/partitarë ose në trajtë elektronike por edhe në inspektime fizike; në kundërshtitë, të cilat kanë të bëjnë me analizën e proceseve dhe së fundmi, kërkimi/hetimi që konsiston në kërkimin e informacionit të personat kompetentë dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.

III/1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:

Bashkia e Kuçovës ndodhet në Qarkun e Beratit, në Jug të Shqipërisë Qendrore, rreth 85 km nga Tirana. Në veri dhe perëndim kufizohet me bashkinë Belsh, në lindje me bashkinë Gramsh, në jug me bashkinë Berat dhe në perëndim me bashkinë Ura Vajgurore. Kryeqendra e bashkisë është qyteti i Kuçovës. Rajoni i Kuçovës përfshin Bashkinë Kuçovë dhe Njësitë Administrative Perondi, Kozarë e Lumas. Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 160.23 km². Popullsia totale është 55,439 banorë nga të cilët 29,760 persona ose 9,849 familje banojnë në Qytetin e Kuçovës, 10,576 banorë ose 2,979 familje në NJA Perondi, 8,058 banorë ose 2,204 familje në NJA Kozarë dhe 7,045 banorë ose 2,054 familje banojnë në NJA Lumas.

Emri i Njësisë	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
Kuçovë	Qyteti: Kuçovë
Kozarë	Fshatrat: Havalehas, Kozarë, Feras Kozarë, Salcë Kozarë, Vlashuk, Demollarë, Fier Mimar, Zdravë, Gegë, Drizë, Frashër

⁶ Risku i Auditimit = Risku i genësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

Perondi	Fshatrat: <i>Perondi, Magjatë, Tapi, Goraj, Velagosht, Rreth Tapi, Polovinë</i>
Lumas	Fshatrat: <i>Lumas, Luzaj, Pëllumbas, Katundas, Zelevizhdë, Belesovë, Mëndrak, Sheqës, Bardhaj, Pashtraj, Vodëz, Krekëz, Koritëz</i>

Të dhëna të tjera

Bazuar në ndarjen e re administrativo-territoriale, qyteti i Kuçovës, ish qyteti naftëtar Stalin, bashkohet me tre komuna, duke kombinuar resurset e tij deri tani të bazuara kryesisht tek nafta, me sektorin bujqësor të këtyre zonave rurale. Burimi kryesor i Kuçovës vazhdon të mbetet nafta dhe gazi, zbuluar hershëm në mënyrë primitive në këtë zonë, që në kohën e mbretërisë së Mbretit Zog, me zbulime të reja në nxjerrjen e naftës në kohën e pushtimit të Italisë, pasuruar me investime në nxjerrjen dhe përpunimin e arit të zi gjatë viteve të diktaturës dhe e shkatërruar pjesërisht gjatë ndryshimit të sistemit në fillim të viteve 1990. Pasuria natyrore e naftës dhe gazit në këtë zonë, vazhdon të konsiderohet ende e lartë, por jo e shfrytëzuar sa duhet si pasojë e mungesës së investimeve në këtë fushë.

Aktualisht zona naftë nxjerrëse është nën administrimin e shoqërisë A.... Ndërmarrja e nxjerrjes së naftës vazhdon punën, ndërsa ajo e përpunimit të naftës jo, pasi nafta bruto përcillet drejt Patosit për t'u përpunuar. Ndërkohë, që resurse të saj janë qindra puse naftë në të gjithë territorin kryesisht në fshatrat Gegë, Havalehas, Frashër, por dhe në qytetin e Kuçovës. Megjithatë, numri i lartë i puseve të naftës, aktive apo të braktisura, ka lënë pas probleme të rënda lidhur me ndotjen mjedisore. Pjesë e resurseve të kësaj bashkie është dhe aerodromi në hyrje të qytetit, aktualisht nën administrimin e NATOS. Kuçova ka pasur dhe ndërmarrje unike në vend si ajo e Riparimit të Avionëve, sot jashtë funksionit.

- Ndikimi i pandemisë COVID-19 në jetën ekonomike

Në zbatim të VKM nr. 236, datë 19.3.2020 "Për marrjen e masave për ofrimin e asistencës në banesë ndaj shtresave në nevojë, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga "COVID-19" dhe Vendimit nr. 2, datë 24.03.2020 të Komisionit Qendror për Ofrimin e Asistencës, Bashkia Kuçovë është përballur me një fluks të madh kërkesash nga familje dhe individë për pako ushqimore dhe jo ushqimore.

Nga ana e qeverisë nuk pati angazhime financiare në lekë, në mbështetje të nenit 65⁷, të ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile". Bashkia Kuçovë ka vijuar punën me fondet e veta dhe njëkohësisht, duke bërë një rishpërndarje të fondeve të Bashkisë Kuçovë, të trashëguara nga viti 2019, si diferenca prokurimi, në shtesë të Programit të mbrojtjes civile, aktiviteti "Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile", në shumën prej 7,890,236 lekë, miratuar me Vendim të KB nr. 46, datë 24.12.2019, nga e cila është përdorur shuma 796,224 lekë për ndihma ushqimore për familje në nevojë. Ndërsa për vitin 2021 me Vendim të KB nr. 01, datë 5.01.2021 është miratuar shuma 15,710,080 lekë, nga e cila është përdorur shuma 160,354 lekë.

III/2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.

Vlerësimi Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2020, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, ligjin nr. 24/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" si dhe udhëzimi MFE nr.08, datë

⁷"Bashkitë, për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, si dhe kryerjen e detyrave në zbatim të këtij ligji, mbështeten në parashikimin minimal prej 4 për qind të totalit të buxhetit vjetor të tyre, të cilat sigurohen nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit"

09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”.

Për auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës ushtrimore raportuese 2020 është marrë në shqyrtim dokumentacioni i mëposhtëm:

- Pasqyrat financiare të vitit 2020;
- Centralizatori/Libri i madh;
- Ditari i Bankës;
- Ditari i Arkës;
- Ditari i Magazinës;
- Ditari i Pagesave;
- Ditari i Veprimeve të ndryshme;
- Aktrakordimin me Degën e Thesarit Kuçovë
- Inventarët fizik të aktiveve, etj.

Pjesë përbërëse e PF/2020 janë

Pasqyra e pozicionit financiar (F1);
Pasqyra e performancës financiare (F2);
Pasqyra e flukseve monetare (F3);
Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto (F4);
Pyetësor dhe shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare (F5)

Pasqyrat statistikore

Investimet dhe burimi i financimit (F6);
Gjendja dhe ndryshimet në aktivet afatgjata, kosto historike (F7.a);
Gjendja dhe ndryshimet në aktivet afatgjata, vlera neto (F7.b);
Numri i punonjësve dhe fondi i pagave (F8)

- Nga auditimi ka rezultuar se:

Njesisë ekonomike raportuese (*Bashkia Kuçovë*), ka përgatitur e raportuar Pasqyrat Financiare të periudhës ushtrimore 2020 mbështetur në ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”. Në përgatitjen, hartimin dhe ndërtimin e pasqyrave financiare të konsoliduar të periudhës raportuese ushtrimore 2020, nuk janë përfshirë njësitë vartëse, si; Qendra Ekonomike e Arsimit (QEA); Drejtoria e Shërbimeve Komunale (DSHK) dhe Qendra Kulturore (QKK) entitete në varësi e pronësi të njësisë ekonomike raportuese(*Bashkia Kuçovë*), që kanë përgatitur pasqyra financiare si njësi ekonomike raportuese të pa varura.

Pasqyrat financiare janë përgatitur e plotësuar sipas kërkesave të UMFE nr.8, datë 09.03.2018 në të cilat është dhënë informacion mbi:

- Emri Njesisë ekonomike raportuese vendore, Bashkia Kuçovë me NIPT K48504103D;
- Periudha kontabël e mbuluar nga pasqyrat financiare (01.01.2020 – 31.12.2020);
- Monedhën e paraqitjes së pasqyrave financiare në lekë;
- Data e hartimit të Pasqyrave Financiare 25.03.2021;
- Përgatitur nga H.SH., Drejtore e Financës, në cilësinë e Nënpunësit Zbatues;
- Pasqyrat Financiare janë dërguar në Degën e Thesarit Kuçovë me shkresën nr.1072/1, datë 26.03.2021, nënshkruar nga Kryetari Bashkisë Kuçovë K.H., në cilësinë e Nënpunësit Autorizues.
- Pjesë përbërëse e dokumentacionit mbi pasqyrat financiare dhe raportimi financiar janë rakordimet mbi shpenzimet dhe të ardhurat me Degën e Thesarit Kuçovë datë 31.01.2021 të konfirmuara dhe nënshkruar nga NZ; NA Bashkia Kuçovë dhe Përgjegjësi Degës së Thesarit Kuçovë.

Baza ligjore mbi të cilën janë hartuar pasqyrat financiare të vitit 2020, janë: - Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë"; - Ligji nr. 68, datë 24.7.2017 "Për financat e Qeverisjes Vendore"; - Udhëzimi nr. 8, datë 9.3.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme"; - Rakordimet e fund vitit për mbylljet vjetore kryhet me Degën e Thesarit; - Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

Nga auditimi i Pasqyrave financiare rezultoi:

I. Pasqyra e pozicionit financiar (F1)

-Aktivet neto janë të barabarta në vlerë 817,254,552 lekë (Aktive –Pasive).

-Aktivet	1,166,948,528 lekë
-Pasivet	349,693,976 lekë
-Aktivet neto	817,254,552 lekë

Aktivet Afatshkurtra:

Aktivet afatshkurta më datë 31.12.2020 paraqiten në vlerën 401,490,746 **lekë** dhe përbëhen nga:

- Llogaritë Klasa (5) "Mjetet monetare e ekuivalentet e tyre" në shumën 62,904,795 lekë;
- Llogaritë Klasa (3) "Gjendje inventari qarkullues" në shumën 4,969,569 lekë;
- Llogaritë Klasa (4) "Llogari të arkëtueshme" në shumën 186,168,199 lekë;
- Llogaritë Klasa (4) "Të tjera aktive afatshkurtra" në shumën (147,448,183) lekë.

-Llogaritë Klasa (5) "Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre" përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2020	Viti 2019	Diferenca 2019-2018
531	Mjete monetare ne arkë	0	0	0
512	Mjete monetare në bankë	0	0	0
520	Disponibilitete në thesar	62,904,795	47,209,254	(15,695,541)
50	Letra me vlerë	0	0	0
00532	Vlera të tjera	0	0	0
54	Akredeitiva dhe paradhënie	0	0	0
59	Provigjone zhvlerësimi letra me vlerë	0	0	0
Totali		62,904,795	47,209,254	(15,695,541)

- Nga të dhënat konstatohet se vlera e llogarisë (520) "Disponibilitete në thesar", paraqitet në shumën 62,904,795 lekë, **veprime të cilat nuk justifikoni gjendjen e lartë të faturave të palikujduara në fund të periudhës 31.12.2020 për shumën 155 milionë lekë.**

Gjendja e llogarisë (85) "Rezultati vitit ushtrimor", paraqitet në shumën 41,051,371 lekë dhe përbëhet nga "Të ardhura për tu përdorur" me vlerë 46,827,201 lekë dhe "Ndryshimi i gjendjes" në vlerën (-5,775,830 lekë). Gjendja e llogarisë (466) "Kreditor mjete në ruajtje" paraqitet në shumën 15,882,787 lekë (garanci objektsh) dhe "Mjete në ruajtje" (pulla takse) me vlerë 194,807 lekë.

1. **Titulli gjetjes:** Në llog. 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”

Situata:

Në llog. 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, paraqitet vlera prej 15,882,787 lekë, e cila përfaqëson detyrimet që Bashkia Kuçovë ka ndaj subjekteve të ndryshme për garanci punimesh (5%), deri më 31.12.2020. Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se vlera prej 10,390,115 lekë për 13 subjekte, nuk u ka përfunduar afati i garancisë së punimeve. Ndërsa vlera prej 5,492,672 lekë për 19 subjekte, përfaqëson detyrime të bashkisë ndaj subjekteve, për garanci punimesh të kryera para vitit 2019, të cilave ju ka përfunduar afati i garancisë së punimeve (të dhëna sipas pasqyrës Aneks 1, bashkëlidhur raport auditimit). Nga ana e Bashkisë Kuçovë, Drejtoria e Financës nuk është marrë asnjë masë për sistemin e kësaj llogarie për rastet ku afati i garancisë së punimeve ka përfunduar

Kriteri:

Ligji nr. 68, datë 24.7.2017 “Për financat e Qeverisjes Vendore” dhe Udhëzimi nr. 8, datë 9.3.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme”.

Ndikimi/Efekti: Pasaktësi në pasqyrat financiare, nga mos sistemi i llogarisë

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi:

Drejtoria e Financës/Buxhet Bashkia Kuçovë, të marrin masa për sistemimin e llogarisë (466) “Kreditorë për mjete në ruajtje”, për rastet kur garancia e punimeve ka përfunduar, duke bërë njoftimin e subjekteve për paraqitjen e dokumentacionit përkatës për kalimin e garancive, ose në rast mos paraqitje në bashkëpunim me Degën e Thesarit të shfrytëzohen të gjitha hapësirat ligjore për sistemin e kësaj llogari.

Llogaritë Klasa (3) “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2020	Viti 2019	Diferenca 2020 - 2019
31	Materiale	2,000,144	1,718,001	282,143
32	Inventari i imët	2,969,425	9,027,398	-6,057,973
33	Prodhim ne proces	0	0	0
34	Produkte	0	0	0
35	Mallra	0	0	0
36	Kafshë në rritje e majmëri	0	0	0
37	Gjendje te pambritura ose pranë të tretëve	0	0	0
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit	0	0	0
39	Provizione për zhvlerësimin e inventarit(-)	0	0	0
	Totali	4,969,569	10,745,399	-5,775,830

Sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar në datë 31.12.2020, llog. Klasa (3) paraqiten në vlerë 4,969,569 lekë e cila përbehet nga llog. (31) “Materiale” në vlerë 2,000,144 lekë dhe llog. (32) “Inventari imët” në vlerë 2,969,425lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit të imët e materiale në shumën 5,775,830 lekë, e cila kuadron me llog. (63) “Ndryshimi gjendjes së inventarit” në shumën 5,775,830 lekë, ku vlera 282,143 lekë, janë shtesë të bërë gjatë vitit dhe 6,057,973 lekë janë paksime. Pakësimi i vlerës prej 6,057,973 lekë, përbëhet nga vlera prej 3,187,272 lekë të cilat i janë transferuar në njësitë vartëse dhe vlera prej 2,986,867 lekë materiale të nxjerrë jashtë përdorimit (procedura e plote trajtuar në fund).

Llogaria (312) “Materiale”, me vlerë (0) lekë lëvizjet e llogarisë për periudhën ushtrimore 2020 paraqiten më poshtë:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2020	1,718,001
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2020	7,913,680
Dalje nga magazina gjatë vitit 2020	5,793,433
Gjendja në 31.12.2020	3,838,248

Nga të dhënat e pasqyruara në tabelë rezulton se, ndërmjet gjendjes në bilanc me gjendjen në fakt ka diferenca në administrim për vlerën 1,838,104 lekë (3,838,248 - 2,000,144). Kjo diferencë vjen për faktin se në llog. 327 janë futur disa artikuj që duheshin në llog. 312, siç mund të jenë dosje me unaza, etj., por që janë sistemuar në pasqyrat e vitit 2020.

Llogaria (327) “Inventari i imët” me vlerë 2,969,425 lekë, përputhet me rezultatin e inventarit vjetor, ndërsa lëvizjet e llogarisë (32) “Inventari i imët” paraqiten më poshtëm:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2020	9,027,398
Hyrje gjatë vitit 2020	116,166
Dalje gjatë vitit 2020	6,174,139
Gjendja në 31.12.2019	2,969,425

Në lidhje me daljet e cila paraqitet në vlerë 6,174,139 lekë, përbëhet nga vlera prej 1,349,168 lekë transferime në njësitë e tjera vartëse. Ndërsa vlera 1,838,104 lekë, paraqet sistemi me llog 312 dhe diferenca në vlerën 2,986,867 lekë janë dalje jashtë përdorimit.

Gjendja e llogarive të analizuar me sipër rezulton se, gjendja fizike është e kuadruar me gjendjen e inventarëve.

Llogaritë Klasa (4) “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra”, përberë nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2020	Viti 2019	Diferenca 2020 - 2019
	3-Llogari të arkëtueshme	186,168,199	187,695,510	-1,527,311
411	Klientë e llogari te ngjashme	0	0	
423; 429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba	0	2,215,990	-2,215,990
431	Tatime e taksa	0	0	
432	Tatime mbledhur nga shteti për llog. Pushtetit Lokal	0	0	
433	Shpenzime fatkeqësi natyrore që mbulon shteti	0	0	
435	Sigurime Shoqërore	0	0	
436	Sigurime Shëndetësore	0	0	
437,438	Organizma të tjerë shoqërore	0	0	
44	Institucione të tjera publike	0	0	
465	Efekte për t'u arkëtuar nga shitja letra me vlere vendosjes	0	0	
468	Debitorë të ndryshëm	167,809,137	123,619,747	44,189,390
4342	Te tjera operacione me shtetin(debitor)	18,359,062	61,677,036	-43,317,974
45	Marrëdhënie me institut. brenda dhe jashtë sistemit	0	0	
49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim(-)	0	0	
	4-Të tjera aktive afatshkurtra	147,448,183	109,695,510	37,752,673
409	Furnitorë (Debitorë),parapagime pagesa pjesore	0	0	
473	Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin	0	0	
477	Diferenca konvertimi aktive	0	0	
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime	0	0	
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	147,448,183	109,695,510	37,752,673

Llogaritë(423;429) “Personeli, paradhënie, deficite e gjoba” në fund të periudhës raportuese 2020 paraqitet në vlerën 0 lekë.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2020	2,215,900
Shtesa gjatë vitit 2020 (D)	0
Pakësime gjatë vitit 2020 (K)	0
Gjendja në 31.12.2020	0

Në llog.423-429, është në vlerën zero nga vlera 2,215,990 lekë, pasi është transferuar në njësitë e varësisë tek "Qendra Ekonomike e Arsimit" (paradhënie për kopshte dhe çerdhe).

Llogaria (468) “Debitorë të ndryshëm” në fund të periudhës ushtrimore 2020 paraqitet në vlerë 167,809,137 lekë e cila përfaqëson detyrimet të lindura nga auditimet e kryera në bashki përfshirë edhe auditimet nga KLSH.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2020	123,619,747
Shtesa gjatë vitit 2020 (D)	54,213,025
Pakësime gjatë vitit 2019 (K)	10,023,635
Gjendja në 31.12.2019	167,809,137

2. **Titulli gjetjes:** *Mangësitë e llog. 468- “Debitorë të ndryshëm”.*

Situata:

Nga auditimi i analizës së llog. 468 “Debitorë të ndryshëm” në vlerën 167,809,137 lekë, u konstatua se përbëhet nga:

Emërtimi i llogarive	Vlera
Llogari (468)	
-Nga aludimi i KLSH	10,460,883
-Nga policia bashkiake	32,500
-Nga banesa të dhëna me qira	8,921,960
-Nga IVMT	31,850,000
-Nga Drejtoria e të Ardhurave	116,280,962
-Te tjera	262,832
Totali	167,809,137

Në lidhje me detyrimet debitorë të mësipërme, Drejtoria e Financës me shkresën përcjellëse nr. 3549, datë 17.10.2018 i është drejtuar Drejtorisë Juridike për ndjekjen e procedurave në arkëtimin e tyre, por nga kjo e fundit nuk është vepruar duke i lënë në heshtje dhe rënduar ndër vite llogarinë.

Kriteri:

Ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” nenet 98-102, ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 21-33 dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 93.

Ndikimi/Efekti:

Mos zbatimi i procedurave ligjore në arkëtimin e detyrimeve, çojnë në mungesë të ardhurash për Bashkinë Kuçovë në shumën 167,80 mijë lekë,

Shkaku:

Përgjegjësi e strukturave përgjegjëse në Bashkinë Kuçovë, në zbatimin e akteve ligjore/nënligjore

Rëndësia: I lartë

Rekomandimi:

Drejtorja e Financë/Buxhet në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Drejtorinë e Taksave Vendore dhe Inspektoratin Vendore Mbrojtjes Territorit (IVMT), të marrin masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e detyrimeve debitorë në vlerën 167,809,137 lekë, të paraqitura në fund të periudhës 31.12.2020, kjo për të ulur nivelin e borxhit dhe rritur nivelin e të ardhurave të Bashkisë Kuçovë.

Llogaria (43;42) “Te tjera operacione me shtetin (debitor)”, në fund të periudhës ushtrimore raportuese 2020. Llogaria (7206) “Financimi pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës Performancës Financiare e cila paraqitet në shumën 31,552,911 lekë, kuadron me llogaritë {(423 (0) + 4342 (17,285,080) + 486 (14,267,831)}. Llogaria (4342), paraqitet me vlerë 18,359,062 lekë e cila përfaqëson nën/llogaritë Klasa (4) të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiare përbëhet nga:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2020	61,677,036
Shtesa gjatë vitit 2020 (D)	12,919,832
Pakësime gjatë vitit 2020 (K)	56,237,806
Gjendja në 31.12.2020	18,359,062

Në mënyrë analitike paraqitet sa më poshtë:

Emërtimi i llogarive	Vlera në lekë
Llogari (401-409)	
Investim	1,073,982
Shpenzime operative	7,017,886
Te tjera	2,413
Paga personeli + sigurime llog (42+435+436)	10,264,781
Faturat e pastrimit të palikujduara dhe dekorit	13,193,849
Gjendja në 31.12.2020	31,552,911

Llogaria (486) “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, në fund të periudhës ushtrimore 2020, paraqitet në vlerën 147,448,183 lekë.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2020	109,695,510
Shtesa gjatë vitit 2020(D)	111,731,394
Pakësime gjatë vitit 2020 (K)	73,978,723
Gjendja në 31.12.2020	147,448,183

Vlera e llog. 486 në shumën 147,448,183 lekë, përfaqëson detyrimet për shpenzime të kryera të financuara në vitin ushtrimor. Kështu gjatë vitit 2020 ka pakësim të llogarisë, pasi janë likuiduar një pjesë e konsiderueshme e këtyre detyrimeve.

Emërtimi i llogarive	Vlera
Shpenzime gjyqësore	473,314
Shpenzime operative (shërbime)	14,435,151
Shpenzime për investime	126,450,093
Detyrime të tjera	6,089,625
Totali	147,448,183

Evidentimi tyre në Pasqyrat Financiare të vitit 2020 është kryer veçmas në përputhje me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018, pika 42.

II. AFATGJATA JOMATERIALE (AAJM).

Llogaritë Klasa (20) “Aktivet Afatgjata Jo materiale”, përbëhen nga llog. (202) “Studime dhe kërkime” në vlerë 18,055,246 lekë. Sipas llogarisë analitike (Tabela nr. 2) vlera e kësaj llogarie është me 17,152,484 lekë. Diferenca prej 902,762 lekë ($18055246 - 17,152,484$), është vlera e amortizimit të AAJM.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2020	18,055,246
Shtesa gjatë vitit 2020 (D)	0
Pakësime gjatë vitit 2020 (K)	(-902,762)
Gjendja në 31.12.2020 (D)	17,152,484

3. Titulli gjetjes: Mbi gjendjen e llogarisë 202- Studime dhe kërkime”

Situata:

Nga analiza e bërë për llog 202, paraqitet në shumën 17,152,484 lekë, sipas kësaj analize:

I.	Studime-Projekte	Shuma 2019
1	Studime dhe kërkime Perondi	2,534,904
2	Plani Përgjithshëm Vendor Perondi	549,019
3	Plani Përgjithshëm Vendor Bashkia Kuçovë	4,044,574
4	Të tjera studime dhe kërkime	225,898
5	Studime dhe kërkime të pa trupëzuara	597,389
6	Projekt për rikonstruksionin e rrugës Ure Vajguore-Kuçove	3,272,701
7	Projekt për rehabilitimin e parkut industrial	5,928,000
	Totali i llogarisë(202)	17,152,484

Nga të dhënat e investimeve, konstatohet se në totalin e llog 202- *Studime dhe kërkime*”, nga 7 projekte që janë në këtë llogari ka përfunduar vetëm për një objekt, konkretisht “*Projekti për rikonstruksionin e rrugës "Ura Vajguore-Kuçovë"*”. Nga Drejtoria e Financës nuk janë bërë përpjekje për sistemin e veprimit kontabël të llogarisë, duke ia bashkëngjitur vlerës së projektit. Sipas Drejt. Financës një veprim i tillë nuk është kryer pasi ky segment rrugorë nuk është aset i Bashkisë Kuçovë, por i Autoritetit Rrugorë Shqiptar.

Kriteri:

Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” dhe UKM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, shkronja (b).

Ndikimi/Efekti: Nuk paraqet një panoramë të qartë të pasqyrave financiare, pa efekt.

Shkaku: Mos zbatim i kuadrit ligjorë për sistemin e llogarive

Rëndësia: *I mesëm*

Rekomandimi:

Drejtoria e Financës të marrë masa për sistemin e llogarisë (202) “Studime dhe kërkime”, duke bërë që në këtë llogari të paraqitet vetëm vlera e projekteve, për të cilat investimet e

lidhura me to nuk kanë përfunduar. Për projektet të cilat kanë përfunduar, vlerat të kapitalizohet sipas objekteve përkatëse dhe regjistrohen në llogaritë përkatësisë, si pjesë e kostos totale të objektit.

II. AKTIVET E AFATGJATA MATERIALE (AAM).

Llogaritë Klasa (21) “Aktivet Afatgjata Materiale”, për periudhën ushtrimore raportuese 2020 paraqiten në shumën 618,428,498 lekë. Në vitin paraardhës 2019 vlera totale e AAM paraqitet në shumën 801,467,409 lekë, pakësuar për shumën (- 183,038,911 lekë), e cila ka ardhur kryesisht si rezultat i transferimit investimeve të ndryshme në ndërtime/ konstruksione dhe rrugë në njësitë vartëse në shumën 150,578,890 lekë, si dhe inventar ekonomik në shumën 910,723 lekë etj.

Llog. Kontabël	Përshkrimi i llogarive	Çelje 2020	Shtesa 2020	Pakësime 2020	Gjendje në fund2020
	AAM	801,467,409			618,428,498
210	Toka ,troje, Terrene	351,104	0	0	351,104
211	Pyje, Plantacione, Kullota	0	0	0	0
212	Ndërtesa e Konstruksione	261,776,515	0	150,866,307	110,910,208
213	Rruge, rrjete, vepra ujore	517,753,292	0	25,887,665	491,865,627
214	Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune	8,693,820	0	7,616,512	1,077,308
215	Mjete transporti	2,063,290	9,909,404	5,547,550	6,425,144
216	Rezerva shtetërore	0	0	0	
217	Kafshe pune e prodhimi	0	0	0	
218	Inventar ekonomik	10,829,388	744,400	3,774,681	7,799,107
219	Amortizimi i AAGJM (-)	156,597,937			150,207,915

4. Titulli gjetjes: Mbi llogarinë 26 “Aktive afatgjata Financiare”

Situata:

Mbi llogarinë 26 “Aktive afatgjata Financiare”, sipas pasqyrës financiare paraqitet me vlerë zero. Bashkia Kuçovë në QKB paraqet aksione me 100% të Klubit të Futbollit “N...” sha me Nipt , e cila është aksionare me objekt “organizim i aktivitetit sportiv në fushën e futbollit. Regjistri si klub në federatën Shqiptare të futbollit dhe në të gjitha llojet e aktiviteteve të futbollit”. Bashkia Kuçovë është aksionere me vlerë 3,500,000 lekë. Kjo vlerë e kapitalit me 100% lekë/aksione pjesëmarrës të bashkisë Kuçovë në “F...” sha, në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të pasqyrave financiare viti 2020, më konkretisht në llog 26 “Aktive afatgjata materiale”.

Kriteri:

Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Urdhrin e MF nr. 64, datë 22.7.2014 “Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabiliteti të Përmisuar”, me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit nr. 5 “Aktivet afatgjata Materiale dhe Aktivet afatgjata Jo materiale”, pika 55,56 dhe 57.

Ndikimi/Efekti:

Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar mbi gjendjen kontabël të paraqitur në pasqyrat e pozicionit financiare viti 2020, të llog 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, gjendje kjo e nën vlerësuar me vlerë 3,500,000 lekë.

Shkaku:

Mos njohja dhe mos zbatim i kuadrit ligjorë në fuqi.

Rëndësia: I lartë

Rekomandimi:

Bashkia Kuçovë, nëpërmjet Nënpunësit zbatues të merren masa për sistemimin në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin e aksioneve tek klub sport “N...” me vlerë 3,500,000 lekë, në debi të llog. 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Llogaria 210 "Toka, troje, terrene", mbetet e pandryshuar nga viti 2019. Gjithashtu dhe **Llogaria 211 "Pyje, Plantacione, kullota"** e cila paraqitet zero, **megjithëse kësaj njësie vendore me VKM nr. 433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave..”,** i janë kaluar në pronësi pyje e kullota (4600 ha, nga e cila pyll prej 3634 ha, djerrë me sip 277.7 ha, bimësi pyjore me sip 240.7 ha, inproduktive 88.3 ha, kullotë 360.1 ha, nuk është kryer asnjë veprim për hipotekimin dhe regjistrimin e tyre as në Drejtorinë Rajonale të ASHK Kuçovë dhe as në kontabilitet.

Sipas njësive administrative kjo sipërfaqe është ndarë:

Njësia Administrative KOZARE me sipërfaqe 976.73 ha

Njësia administrative Perondi me sipërfaqe 328.86 ha

Njësia administrative LUMAS me sipërfaqe 3741.33 ha

Llogaria (212) “Ndërtesa e Konstruksione”, me vlerë historike 222,003,791 lekë dhe vlerë reale 110,910,208 lekë që përfaqëson vlerën neto të ndërtesave të objekteve në administrim e pronësi të Bashkisë Kuçovë gjendje në datë 31.12.2020. Krahasuar me vlerën e periudhës paraardhëse është pasqyruar norma e amortizimit vjetor në vlerë (-9.252.460) lekë dhe blerje te krijuara me pagesë në vlerën 85,979,771 lekë.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2020	185.049.204
Shtesa gjatë vitit 2020 (D)	85.979.771
Pakësime gjatë vitit 2020 (K)	-9.252.460
Gjendja në 31.12.2020 (D)	261.776.515

Llogaria 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore", në shumën 491,865,627 lekë. Shtesa nuk ka, por ka pakësime në shumën 25,887,665 lekë. Kjo vlerë është kaluar me transferim në njësinë vartëse të shërbimeve, pasi nuk janë asetet të Bashkisë Kuçovë.

Llogari 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune", mbetur për shumën 1,077,308 lekë. Nuk ka shtesa për vitin por vetëm paksim në shumën 7,616,512 lekë, nga e cila: vlera 7,223,318 lekë sistemim llogarish për një mjet transporti nga llog 214 për llog. 215, dalje jashtë përdormi në vlerën 99,238 lekë dhe amortizimi në vlerën 293,856 lekë.

Llogaria 215 "Mjet transporti", paraqitet në shumën 6,425,144 lekë. Shtuar gjatë vitit në vlerën 9,909,404 lekë për një mjet të dhuruar në Ministria e Bujqësisë dhe sistemin nga llogaria 214. Është pakësuar për vlerën 5,547,500 lekë, nga e cila: amortizimi në vlerën 1,210,771 lekë dhe transferuar më njësitë vartëse si aset të tyre në vlerën 4,336,779 lekë.

Tabela nr.(2); Llogaria analitike (215).

Nr.	Emërtimi	Targa	Viti		Çmimi	Sipas të dhënave kontabël	
			Prodhim	Blerjes		Sasia	Vlera
I	Bashkia						
1	Automjet Benx blu	A...T		2004	980,000	1	980,000
2	Kamjon SKODA (0776)			2004	1.200.000	1	1.200.000
3	Automjet Rang Rover	A..E		2017	3.576.000	1	3.576.000
4	Eskavator me zinxhir			2017	9.055.196	1	9.055.196
	Vlera totale e Mjete transporti				14,811,196	4	14,811,196

Tabela nr.(3); Llogaria analitike (215), kaluar në Njësitë vartëse.

Nr.	Emërtimi	Targa	Viti		Çmimi	Sipas të dhënave kontabël	
			Prodhim	Blerjes		Sasia	Vlera
I	Bashkia						
1	Autoveturë Tojota policisë	K...B		1999	1.933.866	1	1.933.866
2	Motociklet			2004	80,000	1	80,000
3	Motociklet			2006	80.000	1	8.000
4	Automjet Opel			2004	2.097.000	1	2.097.000
5	Automjet Audi			2004	596.000	1	596.000
6	Kamjon vetshkarkues			2005	995.000	1	995.000
7	Automjet KIA e zezë			2013	150.000	1	150.000
8	Automjet KIA e zezë			2013	150.000	1	150.000
9	Kamjon SKODA (0778)				1.200.000	1	1.200.000
10	Kamjon transport plehra			2006	3.940.062	1	3.940.062
11	Autoveturë BENX			2004	950.000	1	950.000
12	Automjet (motorr makine)			2006	290.000	1	290.000
13	Kamjon IVEKO			2017	1.920.000	1	1.920.000
14	Kamjon MAN			2017	2.664.000	1	2.664.000
	Vlera totale e Mjete transporti				17,045,928	14	17,045,928

Llogaria 218 "Inventarë ekonomike", paraqitet në vlerën 7,799,107 lekë. Shtuar për vitin në shumën 774,400 lekë dhe pakësuar për shumën 3,774,681 lekë, nga e cila: amortizimi në vlerën 2,488,159 lekë dhe dalje jashtë përdorimit në vlerën 1,286,522 lekë.

Llogaria (219) "Amortizimi AAGJM&AAJM", me vlerë 635,580,982 lekë e krahasuar me periudhën 2019 paraqitet me shtesë vlera (24,838,596) lekë, shtesë e cila ka ardhur si rezultat sa më poshtë:

Nr. Reference Llogarie	Teprica Neto	Shtesat gjate vitit		Pakësimet gjate vitit		Teprica ne Fund		
		Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto
b	3	4	5	6	7	8	9	10
I	(AAGJIM)							
20	18,055,246	0	902,762	0	0	28,366,200	11,213,716	17,152,484
201	0					0	0	0
202	18,055,246	0	902,762	0	0	28,366,200	11,213,716	17,152,484
203	0					0	0	0
II								
21- 28	691.109.048	24,383,596	56,699,168	214,715,290	63,991,952	757,422,698	138,994,199	618,428,498
210	351.104	0		0		351.104	0	351,104
211	0	0		0		0	0	0
212	261,776,515	0	13,088,826	167,559,026	29,781,545	140,424,536	29,514,327	110,910,208
213	517,753,292	0	25,887,665	0	0	578,636,750	86,771,123	491,865,627
214	8,693,820	0	239,956	14,186,896	6,864,340	2,974,713	1,897,405	1,077,308
215	2,063,290	23,639,196	14,940,563	27,045,928	22,709,149	14,811,196	8,386,052	6,425,144
216								
217								
218	10829,388	744,400	2,488,159	5,923,440	4,636,918	20,224,399	12,425,292	7,799,107
24	0					0	0	0
28	0					0	0	0
I+II	819,522,655	24,383,596	57,601,930	214,715,290	63,991,952	785,788,898	150,207,915	635,580,982

Përlllogaritja e amortizimit të AAGJM është në përputhje me normat e amortizimit sipas llojit të aktivit përcaktuar në UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika (36).

Llogaria (230; 231) “Investime”, për (AAJM/AAM) sipas të dhënave të paraqitura në Pasqyrën e Pozicionit Financiar për periudhën raportuese ushtrimore 2020 paraqiten me vlerë 129,876,800 lekë, ku nga vlera prej 53,315,549 lekë gjendje më 31.12.2019 kemi një shtesë për vlerën 76,561,251 lekë.

Për investimet e kryera gjatë vitit 2020 është debituar llogarinë (231) dhe kredituar llogaritë Klasa (4) në shumën 129,876,800 lekë. Në fund të vitit me kapitalizmin e tyre është kredituar llogaria (231) dhe janë debituar llogaritë (20) dhe (21) “Aktive afatgjata”.

Tabela nr. (5)-Llogaria analitike (231) date 31.12.2020

Nr.	INVESTIME NE PROCES BILANC 2020	Gjendje me 01.01.2020	Debitimi viti 2020	Kreditimi viti 2020	Gjendje me 31.12.2020
		53,315,573	137,940,067	61,378,816	129,876,824
1	" B..." shpk rik. Rruge Perondi -Lapardha faza I	14,000,000	0	0	14,000,000
2	" S..." shpk rik. Rruge "Perondi - Goraj"	6,573,594	0	0	6,573,594
3	Rik me rërë bituminoze kozare	1,284,000	0	0	1,284,000
4	Rikonstruksion kopshti nr. 1	439,600	3,879,036	0	4,318,636
5	Rikonstruksion "Shkolla 9- vjeçare 18 Tetori"	21,535,256	30,062,716	0	51,597,972
6	“Rehabilitim/Përforsim banesash egzistuese të familjeve në nevojë”.	9,346,000	9,598,219	0	18,944,219
7	Permiresim I banesave kom.varfera		22,667,357	0	22,667,357
8	Rikualifikim urban I."1Maj"		10,304,700	0	10,304,700
9	Rikualifikim urban I."1Maj" kolaudim	137,123	0	0	137,123
10	Sheshi 18 Tetor		49,223	0	49,223

III. PASIVET (DETYRIMET).

Pasivet Afatshkurtra;

Llogaritë Klasa (4), në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Kuçovë më 31.12.2020, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2020, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2020, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

Llogaritë	Përshkrimi	Viti 2020	Viti 2019	Diferenca/ ndryshimi
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	1,238,020	124,069,552	-122,831,532
42	Detyrime ndaj personelit	7,951,719	7,283,882	667,837
431	Detyrime ndaj shtetit tatim taksa	399,156	366,183	32,973
435	Sigurime shoqërore	1,657,073	1,733,801	-76,728
436	Sigurime shëndetësore	229,959	240,950	-10,991
438	Organizma të tjera shtetërore	48,990	50,827	-1,837
45	Mardhënie midis institu, apo njërive	387,345	958,510	-571,165
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	16,077,594	15,065,675	1,011,919
467	Kreditorë të ndryshëm	153,848,741	38,884,831	114,963,910
4341	Operacione me shtetin (detyrime)	552,838	552,838	0
	Gjendja më fund të periudhës	182,391,435	189,207,049	-6,815,614

Llogaria (401-408) “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, në fund të vitit 2020 është në vlerën 1,238,020 lekë, paraqet gjendjen e faturave të palikujduara nga Bashkia Kuçovë më

31.12.2020. Lëvizja e llogarisë (401-408) “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, paraqitet në tabelën si me poshtë:

Llog. 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”	
Çelje e vitit 2020	124,069,522
Shtesa gjatë vitit 2020(K)	46,877,754
Pakësim gjatë vitit 2020(D)	169,709,285
Gjendja në 31.12.2019 (K)	1,238,020

Gjendja e llogarisë (401-408) në shumë 1,238,020 lekë, përbëhet nga fatura të palikujduara për detyrime në (investime/ mallra) të muajit Dhjetor, por që likuidohen në muajin Janar të vitit pasardhës.

Llogaria (42) “Detyrime ndaj personelit”, sipas pasqyrave financiare të paraqitura pranë Bashkisë Kuçovë, paraqitet në vlerën 7,951,719 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës.

Llogaria (431) “Detyrime ndaj shteti për tatim taksa”, paraqitet në vlerën 399,15,6 lekë dhe përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin Dhjetor, këtu janë dhe pagat e këshilltarëve.

Llogaria (435) “Sigurime shoqërore” dhe llogaria (436) “Sigurime shëndetësore”, paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor që paguhen në muajin Janar dhe janë përkatësisht në vlerat 1,657,073lekë dhe 229,959 lekë.

Llogaria (466) “Kreditore për mjete nën ruajtje” sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Kuçovë, në fund të vitit 2020 paraqitet në vlerën 16,077,594 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së objekteve në masën 5%, ose shumën 15,882,787 lekë dhe vlerën e pullave të gjendjes civile të muajit dhjetor në shumën 194,807 lekë. Vlera e mësipërme është e rakorduar me Degën e Thesarit Kuçovë, sipas Aktrakordimin të konfirmuar me shkresë nr. ekstra, datë 31.01.2020.

Llogaria (467) “Kreditorë të ndryshëm”, paraqiten faturat e pa likuiduara për investime dhe shërbime të cilat nuk bëhen hyrje dhe për vitin 2020 paraqiten në shumën 153,848,741 lekë. Lëvizja e kësaj llogarie gjatë vitit 2020 paraqitet si më poshtë:

Llog. 467 “Kreditorë të ndryshëm”	
Çelje e vitit 2020	38,884,831
Shtesa gjatë vitit 2020	252,229,274
Pakësime gjatë vitit 2020	137,265,364
Gjendja në 31.12.2020	153,848,741

5. Titulli gjetjes: Mbi llogarinë 231 “Për aktivet afatgjata materiale” dhe 467 “Kreditor të ndryshëm”

Situata:

Nga përpunimi i të dhënave mbi llog (231), e cila paraqitet në shumën 129,876,824 lekë, u konstatua se për disa objekte megjithëse kanë përfunduar, nuk është bërë sistemi i tyre nga llog (231) në llogarinë (212), pasi objektet kanë përfunduar, *konkretisht:*

Nuk janë kryer veprime kontabël për sistemin llogarish nga llog (231) në llog (212), kjo për objektin “*Rruga Perondi – Lapardha faza I*”, objekti “*Rruga Perondi – Goraj*” dhe objekti “*Rikonstruktion me rërë bituminoze*”

Gjithashtu evidentohet fakti se llogaria (467) “*Kreditor të ndryshëm*”, sipas analizës së bërë për disa nga objektet vlera e faturës kreditorë më 31.12.2020, kemi mos përputhje me faturës kreditore të paraqitur në fund të vitit me vlerë reale që duhet të ishte, *konkretisht*:

- Objekti “*Permiresim I banesave kom.varfera*”, me vlerë kontrate 27,709,197 lekë. Likuiduar deri datë 31.12.2020 shumë 22,667,357 lekë dhe diferenca pa likuiduar akoma për mungesë fondesh në shumën 5,041,840 lekë. Sipas analizës së pasqyrës së kreditorëve, ky objektet paraqitet për vlerën 1,073,982 lekë, **pra me një diferencë më pak sipas analizës për vlerën 3,967,858 lekë.**

- Nga auditimi u konstatua se detyrimet e raportuara në fund të vitit 2020 në vlerën 155,086,764 lekë (*të akumuluar*) dhe fondet e miratuara për shpenzime të këtij viti në vlerën 727,616,364 lekë. Kjo situatë tregon se Bashkia Kuçovë mund të konsiderohet me probleme financiare në fund të vitit ushtrimor 2020, pasi vlera e stokut të detyrimeve të papaguara ndaj palëve të treta është 21.3 %, pra mbi nivelin prej 15 % të shpenzimeve vjetore të miratuara. Nëse situata nuk një përmisim, bashkia mund të kalojë dhe në vështirësi financiare, ku stoku i detyrimeve të prapambetura mund të kalojë 25% e shpenzimeve vjetore të miratuara.

Kriteri:

Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” dhe UKM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe neneve 55 dhe 56, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Ndikimi/Efekti:

Nuk paraqesin një situatë të saktë të llogarive të pasqyrave financiare

Shkaku:

Mos zbatim i akteve ligjore të kontabilitetit, si dhe parimeve kontabël.

Rëndësia: I mesëm

Rekomandimi:

Bashkia Kuçovë, nëpërmjet Nënpunësit Zbatues të marrë masa për:

- Sistemin në kontabilitet të llogarisë (231) në llogaritë (213) ose (213), sipas objekteve pasi një pjesë e tyre janë mbyllur dhe duhet të kapitalizohet në aktive afatgjata materiale.

- Të sistemohen diferencat e faturave gjendje në fund të vitit 2020 në llogarinë 467, për një paraqitje të saktë të faturave të palikujduara në fund të periudhave ushtrimore, kjo për shumën 3,967,858 lekë në objektin “*Permiresim I banesave kom.varfera*” .

- Të marrë masa për planifikimin e procedurave në raport me nivelin e të ardhurave të arkëtuara në fakt dhe fondeve të deleguara dhe të mos planifikohet procedura të tjera pa mundësuar likuidimin e detyrimeve të prapambetura, kjo për të shmangur fenomenin e rritjes së faturave të palikujduara në fund të periudhës ushtrimore si rezultat i mos realizmit të të ardhurave dhe për të shmangur problemet financiare që kjo njësi ka dhe vështirësinë financiare që pritet të futet, pasi stoku i detyrimeve të prapambetura mund të kalojë 25% e shpenzimeve vjetore të miratuara.

Llogaria (85) “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore”, paraqitet me teprice kreditorë në vlerën 41,051,371 lekë dhe paraqet rezultatin nga funksionimi. Ajo është e barabartë me vlerën e të ardhurave që Bashkia Kuçovë trashëgon për t’u përdorur në vitin pasardhës sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe në përputhje me Aktrakordin e mbajtur me degën e thesarit Kuçovë mbi fondet që trashëgohe dhe ndryshimin e gjendjeve të inventarit.

Llog. 85 "Rezultati i ushtrimit"	
Çelje e vitit 2020	49,369,585
Shtesa gjatë vitit 2020	605,193,741
Pakësime gjatë vitit 2020	613,511,599
Gjendja në 31.12.2020	41,051,371

- Pasqyra e Performancës financiare (F2).

Të ardhurat dhe shpenzimet e paraqitura në Pasqyrën e Performancës Financiare të Bashkisë Kuçovë më datë 31.12.2020 janë të kuadruar me Degën e Thesarit Kuçovë:

Rakordimi të ardhurave

	Emërtimi	Vlera sipas Pasqyrës së Performancës	Dokumentimi	Vlera	Diferenca
I	-Të ardhurat e krijuara gjatë vitit Granti korente i brendshëm;	115,746,620	Aktrakordin me Degën e Thesarit		
	-Nga buxheti për NJQP (qendrore)	228,632,080	Sipas çeljes së buxhetit nga MFE	381,051,799	46,827,201
	-Nga buxheti për NJQP (vendore)	246,456,174	Sipas llogarisë 7206	31,552,911	
	-Financim i pritshëm nga buxheti	31,552,911	Aktrakordin me Degën e Thesarit	108,749,633	
			Nga rezultati i vitit të mëparshëm llog.85	47,209,254	
	Totali të ardhura	622,387,785	Totali të ardhura	664,154,282	46,827,201

Diferenca në shumën 46,827,201, për të ardhurat e realizuara nga Bashkia Kuçovë, midis Pasqyrës së Performancës Financiare dhe Aktrakordin me Dega Thesarit Kuçovë, përfaqëson të ardhurat e realizuara e trashëguara nga viti i mëparshëm.

Rakordimi Shpenzimeve.

Emërtimi	Sipas Situacionit	Detyrimet e vitit 2019	Detyrime të vitit 2020	Sipas Pasqyrës së Performancës
600	83,212,174	8,494,165	9,100,918	83,818,927
601	13,706,392	1,181,478	1,163,863	13,688,777
602	61,154,854	28,577,945	21,285,717	53,862,626
604	1,901,042	955,308	631	946,365
606	227,734,243	1,415,000	1,782	226,321,025
T tjera	196,922,864			196,922,864
shuma	584,631,569	40,623,896	31,552,911	575,560,584
63	0			5,775,830
Totali	584,631,569	40,623,890	31,552,911	581,336,414

Diferenca në shumën 196,922,864 lekë midis shpenzimeve të paraqitura në Pasqyrën e Performancës Financiare dhe sipas akt rakordimet të të ardhurave që i përkasin transfertës së njësive shpenzuese në varësi. Vlera prej 46,827,201 lekë e ardhura e trashëguar në vitin e ardhshëm, si dhe vlerës (5,775,830) lekë “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”.

Rakordimi të ardhura, shpenzime dhe rezultati

	Emërtimi Burimi	Pasqyra	Situacioni	Diferenca
I	Totali të ardhura	616,945,028	616,945,028	
II	Shpenzime	581,336,414	581,336,414	
III	Rezultati i vitit ushtrimor	41,051,371	41,051,371	

Në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, llogaria (85) “Rezultati veprimtarisë ushtrimore” paraqitet në shumën 41,051,371 lekë, në Pasqyrën e Performancës Financiare paraqitet në shumën 41,051,371 lekë. Kjo vlerë përfaqëson të ardhurën e trashëguar për tu përdorur 46,827,201 lekë dhe ndryshimin e gjendjeve (5,775,830) lekë.

Diferenca është 0 (zero) lekë, përfaqëson vlerën e pasqyruar në Pasqyrën statistikore nr.6 “Investimet dhe burimi i financimit”, Burimet për investime, Fonde të tjera të veta, llogaria (115) “Caktim fondi për investime” në shumën 0 (zero) lekë.

Nga kontrollët e kryera rezultoi se teprica e llogarisë së likuiditeteve më datë 31.12.2020, e paraqitur në këtë pasqyrë rezulton në shumën 46,827,201 lekë dhe kuadron me tepricën e likuiditeteve të paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, në Aktiv I-“Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” e cila paraqitet në shumën 46,827,201 lekë.

Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto (F4).

Nr. llog	Emërtimi	Fonde bazë dhe grante kapitale	Rezultatet e mbartura	Rezultatet e ushtrimit	Gjithsej aktive neto/fonde neto
101	Aktivet neto	915,727,181	0	0	915,727,181
	Ndryshimet në aktivet neto	0	0	-98,472,629	-98,472,629
105	Nga burime të brendshme	0	0	63,005,515	63,005,515
	Grante të brendshme kapitale	0	0	2,686,086	2,686,086
	Transferta të brendshme (grante në natyre)	0	0	14,300,136	14,300,136
115	Nga fondet e veta te investimeve				
12	Nga rezultatet e mbartura (+/-)	0	0	0	0
85	Nga rezultatet e vitit ushtrimor (+/-)	0	0	8,907,792	8,907,792
1013	Nga konsumi i AAGJ	0	0	-43,872,138	-43,872,138
1015	Nga nxjerrjet jashtë përdorimit	0	0	-1,385,760	-1,385,760
1016	Nga transferta brendshme të AAGJ (+/-)	0	0	-142,114,260	-142,114,260
Totali		915,727,181	0	-98,472,629	817,254,552,

Nga verifikimi i kryer rezultoi se, vlera totale e Aktiveve neto/fonde neto të paraqitura në “Pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto”, është e barabartë me vlerën e tyre të paraqitur në pasqyrën e “Pozicionit financiar”; D “Fondi konsoliduar” në shumë 817,254,552 lekë. Në këtë pasqyrë janë paraqitur saktë grantet bazë (çelja e vitit), rezultati vitit të mëparshëm si dhe rezultatet e ushtrimit.

Vlera 817,254,552 lekë, përfaqëson shtesat e aktiveve neto/fonde neto gjatë vitit ushtrimor, të pasqyruara në të njëjtën vlerë edhe në Librin e madh në kredi të llogarisë 101 "Fonde bazë".

-Vlera 63,005,515, lekë përfaqëson financimin shtesë investimet ne proçes, të likuiduara gjatë periudhës ushtrimore;

-Vlera 2,686,086 lekë përfaqëson shtesën AAGJ (grante ne natyrë).

-Vlera 14,300,136 lekë përfaqëson financimin e investimeve në proçes nga te ardhurat e veta.

-Vlera 43,872,138 lekë përfaqëson amortizim vjetor AAGJ(shtesa/pakësime)=(43,872,138-0);

-Vlera 142,114,260 lekë përfaqëson pakësim objekte inventari AAGJ të transferuara pa pagesë në njësi shpenzuese në vartësi.

-Vlera 1,385,760 lekë përfaqëson pakësim nga nxjerrjet jashtë përdorimi.

Vlera 8,907,792 lekë përfaqëson rezultatin financiar të vitit ushtrimor pasqyruar në llog.(85) “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” (46,827,201 - 32,143,579-5,775,830 = 8,907,792).

Nga auditimi rezultoi se, fondet neto të evidentuara në Pasqyrën “Ndryshimi në fondet neto/aktivet neto” në shumën 817,254,552 lekë kuadron me evidentimin e tyre në pasqyrën e “Pozicionit financiar”; C “Aktivet neto/Fondet (A-B)”.

Pasqyra statistikore nr.(6) “Investimet dhe burimi i financimit”.

Nr. llogarie	Emërtimi	Vlera
	Shpenzimet për investime	53,315,549
230	Shpenzime afatgjata jo materiale	0
231	Shpenzime Afatgjate materiale Gjendja në fillim të vitit)	53,315,549
	Burimet për investime	77,305,651
1050	Grante kapitale nga buxheti	5,677,377
1051	Grante kapitale nga nivele te tjera	57,328,138
11	Fonde të tjera të veta	0
115	Caktim fondi për investime nga rezultati	14,300,136
	Kalim në AQT	744,400
	Balanca	-129,876,800

-Vlera prej 129,876,800 lekë përfaqëson shpenzime për investime në proces të rakorduar me Degën e Thesarit Kuçovë.

-Vlera prej 77,305,651 lekë përfaqëson vetëm burimet e financimit të cilat përbëhen nga transfertat e pakushtëzuar (shpenzime faktike $137,940,067 - 61,378,816 = 77,305,651$ leke) sipas rakordimit në thesar në të njëjtën shumë.

Tabela nr.(5); Llogaria analitike (212).

Nr.	Emërtimi	Viti prodhim it	Sasia	Trualli nën ndërtesat	Dokumenti pronësisë			Drejtoria e Financës	
					certifikat	vërtetim	Pa pronësi	Sasia	Kontabiliz uar
1	Bashkia	Ska	187	21.580	30	58	99	17	po
2	NJ.AD Kozare	Ska	20	2.721	0	0	20	3	po
3	NJ.AD Lumas	Ska	39	7.607	0	0	39	1	po
4	NJ.AD Perondi	Ska	48	5.934	0	0	48	22	po
	Totali		294	37.842	30	58	206	43	

Nga auditimi mbi dokumentacioni e vendosur në dispozicion nga DPZHT të krahasuara me kartelat në kontabilitet të Drejtorisë së Financës për ndërtesat e objekte të administruara në llog.(212) “Ndërtesa e Konstruksione” u konstatua se; Njësia publike vendore Bashkia Kuçovë, sipas DPZHT ka në administrim gjithsej **294 objekte** ndërtesa dhe konstruksione të ndryshme me sipërfaqe trualli nën këto objekte prej **37.842 m²**, nga të cilat dokumente të pronësisë (certifikatë, apo vërtetim hipotekor) disponohen vetëm për **88 objekte**, kurse për **206 objekte** nuk disponohet asnjë lloj dokument pronësie. Nga këto objekte Drejtoria e Financës ka të administruara në kontabilitet vetëm **43 objekte** “ndërtesa e konstruksione”, ndërmjet të cilëve ka edhe objekte që nuk i disponon në evidencë DPZHT. Objektet janë të trashëguara dhe të mbartura nga njësitë që u shkrinë (ish/komunat) në periudhat raportuese para vitit 2015 të pa shoqëruar me kartela objekti, nuk evidentohet viti ndërtimit, në disa objekte vlera historike pasqyrohet me **0(zero)**, njëkohësisht ka mospërputhje ndërmjet të dhënave të kontabilitetit nga Drejtoria e Financës me ato që evidenton DPZHT. Në këto kushte për mospërputhjet në administrimin për çdo objekt të “ndërtesave e konstruksioneve” nga njësia publike vendore Bashkia Kuçovë kërkohet menjëherë të bëhet saktësimi objekteve, dokumentimi me kartelë objekti, inventarizim fizik i objektit, si dhe rivlerësime normat për secilin objekt, veprim në mospërputhje me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për inventarizimi dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu (VI) “Transferimi pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, pika (1); (2).

6. Titulli i gjetjes: *Mbi kontabilizimin e administrimin e Aktiveve Afatgjata Materiale llog.(212) Ndërtesa e konstruksione, pa titull pronësie*

Situata:

Nga auditimi rezultoi se, nga 294 objekte inventari në ndërtesa e konstruksione të administruara llog.(212) pasuri e paluajtshme (*sasi e vlerë*) pjesa e konsiderueshme e tyre prej 251 prona (*trajtuar analitikisht*) nuk janë të regjistruara në kontabilitet dhe pasqyrat financiare në aktiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, pasi 206 objekte janë të trashëguara nga (*ish/komunat*) NJSH, ndërsa 45 objekte të trashëguara nga ish/Bashkia, të mbartura nga periudhat raportuese paraardhëse (viti 2015), sipas gjendjes kontabël dhe inventar, për të cilat nuk posedohet asnjë titull pronësie (*certifikatë, apo vërtetim*).

Gjithashtu, sipas të dhënave të Sektorit të Aseteve pranë Drejtorisë së PZHT, u konstatua se një pjesë e pronave janë regjistruar nga Bashkia Kuçovë në Drejtorinë rajonale të ASHK Kuçovë, por pa vlerë. Kështu gjithsej janë regjistruar 210 prona por pa vlerë, gjë e cila vështirëson procesin e kontabilizimit në pasqyrat financiare si asetet të Bashkisë Kuçovë. Për rrjedhojë kontabilizimi i AAM, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur.

Kriteri:

-VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu (VI) “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme” dhe veprim në mospërputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me ndryshime, Kreu (III), pika 35 dhe Kreu (II), pika (16)

Ndikimi/Efekti:

Mungesa e titullit të pronësisë dhe veçanërisht mos pasqyrimi i gjendjes reale të administrimit të objekteve, ndërtesa e konstruksione në njësinë publike vendore Bashkia Kuçovë ka sjellë:

- pengesë në kryerjen e transaksioneve të ndryshme me pasuritë e paluajtshme;
- pengesë për menaxhimin e risqeve dhe mbrojtjen ndaj tyre, pasi mungesa e titullit të pronësisë pengon sigurimin e tyre.
- kontabilizimin në librat e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare nuk mund të kryhet pa u mbështetur në dokumentacion vërtetues të titullit të pronësisë. Titull i cili vërteton pronësisë dhe ushtrimin e të drejtave mbi një pasuri të paluajtshme

Shkaku:

Nga ballafaqimi problematikës gjatë procesit të auditimit në terren, ndërmjet evidentimit të objekteve ndërtesa e konstruksione që pasqyrojnë DPZHT me ato që pasqyrojnë në kontabilitet Drejtoria e Financës rezultoi se, ndërmjet tyre ka diferenca dhe shkak i kësaj gjendjeje edhe 5 vite më pas janë:

- dokumentacioni i paplotë i trashëguar nga NJSH (*ish-Komunat*);
- vështirësia e hasur në plotësimin e dosjeve sipas kërkesave të akteve ligjore e nënligjore për regjistrimin e titujve të pronësisë;
- kostoja e kryerjes së këtyre veprimeve në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme e cila është e konsiderueshme referuar numrit të objekteve të cilët duhet të regjistrohen

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi:

- Titullari i Bashkisë Kuçovë, nëpërmjet Sektorit të Aseteve pranë Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (DPZHT), të marrë masa që të përgatisë dosjet me dokumentacionin e nevojshëm për regjistrimin e pasurive të paregjistruara në Drejtorinë Rajonale ASHK Kuçovë të pasurive të paregjistruara, ndërsa Drejtoria e Financës të

përlllogarisë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimit, burimet e financimit me qëllim marrjen sa më parë të titujve të pronësisë të pasurive të paluajtshme.

- Kryetari i Bashkisë Kuçovë në cilësinë e Nënpunësit Autorizuar në bashkëpunim me Drejtorin e Financës në cilësinë e Nënpunësit Zbatues, të ndërmarr të gjitha procedurat ligjore për vlerësimin e aktiveve të cilat janë pjesë e inventarit AAGJ të bashkisë, të certifikuara në ASHK Kuçovë, por pa vlerë respektive, me qëllim paraqitjen e vlerës së këtyre aktiveve në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të njësisë publike vendore bashkia Kuçovë më 31.12.2021.

7. Titulli i gjetjes: *Mbi rivlerësimi Aktiveve Afatgjata Materiale (ndërtesa e konstruksione, etj.).*

Situata:

Nga auditimi rezultoi se, vlera e AAM/JM të paraqitura në Pasqyrat e Pozicionit Financiar, nuk evidentojnë “vlerën reale” të tyre, pasi nga ana e Bashkisë Kuçovë nuk është ndërmarrë asnjë procedurë rivlerësimi ndaj tyre, bazuar në SKK (5) “Aktive afatgjata materiale e aktive jo materiale”, paragrafi “Trajtimet kontabël për aktive afatgjata materiale”, pika (23-32) “Modeli rivlerësimit”. Vlerat fillestare, apo kostot historike të këtyre aktiveve rezultojnë sipas çmimeve të blerjes, si dhe kosto të tjera të drejtpërdrejta në periudhat përkatëse të krijimit, të cilat referuar në gjendjen që pasqyron kontabiliteti llog.(212) “Ndërtesa e konstruksione” për 251 (294-43) objekte (ndërtesa e konstruksione të ndryshme, etj) me vlerë 0 (zero) lekë e cila ka sjellë një situatë që vlera e aktiveve të nënvlerësohet, në lidhje me vlerësimin e aktiveve.

Gjithashtu për asnjë nga periudhat që nga momenti i bashkimit të ish komunave në një bashki, nuk është kryer inventarizimi i asteve që Bashkia Kuçovë ka të regjistruara në pasqyrat financiare, gjë e cila bëhet me evidente nga bashkia me ish komunat dhe nuk dihet me saktë si gjendje fizike e tyre.

Kriteri:

Udhëzimin e MF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar , Kapitulli IV-Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, "Inventarizimi i aktiveve".

UMF nr. 08, datë 09.03.2018: Kap.(IV) “Përgatitja dhe rregullat e plotësimit të pasqyrave financiare vjetore të konsoliduar”, pika (105) Hapat që ndiqen për konsolidimin e pasqyrës së pozicionit financiar janë:

“...Vlerësohen dhe kontabilizohet aktivet e pavlerësuar...”

-Aneksi 1 “Analizë e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”, Hyrjet e Aktiveve Afatgjata Materiale dokumentohen për:

“Për blerjet, ku si dokumente shërbejnë: kontrata, fatura e furnitorit, dhe akti i marrjes në dorëzim ose fletë-hyrja (nëse janë aktive të magazinueshme).

-Për hyrjet në cilësinë e kontributeve në natyrë të kapitalit/fondeve, ku si dokument shërben akt marrëveshja dhe akti i marrjes në dorëzim të aktivit.

-Për përfitimet nga dhurime, ku si dokument është akti i dhurimit dhe akti i marrjes në dorëzim.

-Për prodhimin nga vetë njësia, ku si dokument shërben situacioni përfundimtar dhe akti i marrjes në dorëzim.

-Për rivlerësimet, shërbejnë aktet ligjore ose nënligjore që autorizojnë një gjë të tillë dhe pasqyrat përkatëse të llogaritjeve”.

Gjithashtu, duhet të kryhen veprimet kontabël në rast të diferencave nga rivlerësimi i Aktiveve Afatgjata Materiale:

-Debi llog. 21 në kredi llog.109 (Diferenca nga rivlerësimi në rritje);

-Kredi llog. 21 në debi llog. 109 (diferenca nga rivlerësimi në ulje)

Ndikimi/Efekti:

Mungesa e rivlerësimit të aktiveve, sjell një pasqyrim jo real të vlerës së tyre në pasqyrat financiare.

Shkaku:

Nga ballafaqimi problematikës gjatë procesit të auditimit në terren, ndërmjet evidentimit të objekteve ndërtesa e konstruksione që pasqyrojnë DPZHT me ato që pasqyrojnë në kontabilitet nga Drejtoria e Financës, ka rezultuar se nuk janë ndërmarrë procedura për rivlerësim për shkak të kostos që kërkon kryerja e këtij shërbimi.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi:

Titullari i Bashkisë Kuçovë në cilësinë e Nënpunësit Autorizues, të marrë masa të menjëhershme për të kryer procedurat ligjore të rivlerësimit të aktiveve afatgjata materiale (*ndërtesa e konstruksione*), pasqyrimin e tyre në kontabilitet me vlerë reale historike (*referuar tregut*), si dhe kryerjen e veprimeve kontabël referuar rezultatit (*rritje/ulje rivlerësimi*), respektivisht në llogaritë përkatëse (21) “Aktive afatgjata materiale” e llog.(109) “Diferenca nga rivlerësimi”.

Të ngrejë një grup pune me specialit të fushës, për kryerjen e inventarizimit të asteve të Bashkisë Kuçovë, të paraqitura në pasqyrat financiare, mbi evidentimin e gjendjes së tyre në fakt dhe në rast mungesë të ndiqen procedurat ligjore për sistemin dhe nxjerrje përgjegjësie.

- *Auditimi mbi inventarizimin e llogarive të Aktiveve Afatgjata Materiale; Jo materiale dhe Qarkulluese, sipas klasifikimit të tyre e mbajtjes së kartelave, raportimi i shtesave, apo përmirësimeve të kryera për gjatë periudhës raportuese në aktivin e duhur, për periudhën ushtrimore raportuese 2020.*

Në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015; ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin e pasqyrat financiare”, pika (1), neni (7) “Inventari aktiveve e detyrimeve”; UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu (IV) “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, inventarizimi i aktiveve” pika (81) dhe UMF nr. 28, datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësite publike”, në njësinë publike vendore Bashkia Kuçovë u auditua procedurat e ndjekura për kryerjen e inventarizimit fizik të pasurisë të administruara në llogaritë; “aktive afatshkurtër”; “gjendje inventar qarkullues”; “materiale”; “inventar i imët”; “Aktive afatgjata jo materiale” dhe “Aktive afatgjata materiale”.

Nga auditimi mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion për periudhat raportuese objekt auditimi (2020), u konstatua se, për realizimin e procesit të inventarizimit fizik të “aktiveve afatgjata dhe afatshkurtër” (*materiale e jo materiale*) dhe “inventar qarkullues” të pasurisë, Aseteve dhe vlerave materiale në përdorim të njësisë publike vendore Bashkia Kuçovë për periudhën raportuese ushtrimore 2020, Titullari i ka nxjerr urdhrin e brendshëm nr. 301, datë 08.10.2020 “Për caktimin e komisionit përgjegjës për përditësimin, evidentimin dhe kontrollin fizik të inventarit të pronave publike të Bashkisë Kuçovë” me përbërje; R.D. me funksion kontabilist, B.D. me funksion specialist në DPZHT dhe z. TH.B. me funksion Specialist në DAV Bashkia Kuçovë, me afat përfundimi deri në fund të vitit 2021.

Në përfundim të procesit të inventarizimit fizik, komisioni ka paraqitur vetëm një relacion për fletë inventarët me gjendje fizike e kontabël në objektet e inventarizuara sipas llogarive inventariale, ka paraqitur përmbledhëse me rezultatet e inventarit fizik.

Nga auditimi u konstatuan disa mangësi e shkelje në zbatimin e dispozitave ligjore pa ndikim në evidentimin e gjendjes reale të aktiveve në pasqyrat financiare të periudhës raportuese me hollësisht sa më poshtë;

1- Në momentin e fillimit të inventarizimit në objekt, anëtarët e komisionit të inventarizimit në asnjë rast nuk kanë përpiluar deklarata për konflikt të interesit me punonjësit me përgjegjësi materiale, ose që kanë në përdorim aktive dhe në rastet kur anëtar komisioni inventarizimi është përfshirë drejtuesi i njësisë që inventarizohet njëkohësisht edhe përgjegjës material, veprim në mospërputhje me ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 82.

2- Komisioni inventarizimit fizik në fillim të procesit, në asnjë rast nuk ka hartuar Aktrakordimin për të përcaktuar e fiksuar numrin rendor të fletëhyrjes dhe fletëdaljes së fundit e kontabilizuar, veprim në mospërputhje me UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 83.

Komisioni inventarizimit ka paraqitur fletë inventarët me gjendje fizike e krahasuar kjo me gjendjen kontabël(vlera historike) në objektet e inventarizuara sipas llogarive kontabël të evidentuara në përmbledhëse me rezultate të evidentuara edhe në pasqyrat financiare (*bilanci kontabël*) për periudhën raportuese e mbyllur në datë 31.12.2020 për 9 llogari me analizë për secilin aktiv afatgjatë material, jo material dhe qarkullues sa më poshtë;

Nr.	Llog.	Aktivet Afatgjata						Inventari Qarkulluese		
		Afatgjata jo materiale			Afatgjata materiale			Inventari	Pasqyra	Mungesa
		Inventar	Pasqyra	Difer	Inventari	Pasqyra	Mungesa			
1	202	Painven	28.366.200	Kontabël	0	0	0	0	0	0
2	210	0	0	0	Pa inventar	351.104	Kontabël	0	0	0
3	212	0	0	0	Pa inventar	307.983.562	Kontabël	0	0	0
4	213	0	0	0	Pa inventar	578.636.750	Kontabël	0	0	0
5	214	0	0	0	2,974,713	2,973,991	722	0	0	0
6	215	0	0	0	14,811,196	14,811,196	0	0	0	0
7	218	0	0	0	20,224,399	20,224,299	100	0	0	0
8	31	0	0	0			0	48,464	48,646	0
9	32	0	0	0		0	0	1,951,682	19,862,582	0
					Totali		822			0

Shënim: Të dhënat janë disponuar nga Drejtoria e Financës dhe pasqyrat financiare.

Të dhënat në tabelë evidentojnë faktin se, për 3 llogari ekonomike, komisioni nuk ka kryer proces inventarizimi për gjendjen fizike të aktiveve, ndërsa në pasqyrat financiare evidentohej vetëm gjendje kontabël dhe për 4 llogari ekonomike gjendja kontabël e aktive afatgjatë (*materiale e jo materiale*) dhe qarkulluese e deklaruar në pasqyrat financiare, nuk evidenton rezultatet e gjendjes fizike të inventarit, ndërsa rezultojnë diferenca të cilat në përfundim të procesit të inventarizimit dhe gjatë hartimit të pasqyrave financiare janë sistemuar.

8. Titulli gjetjes: Diferenca të konstatuara në inventar.

Situata:

Të dhënat në tabelë përmbledhëse të inventarizimit janë konstatuar, diferenca në administrimin e aktiveve, ndërmjet gjendjes fizike të inventarit fizik dhe gjendjes kontabël vlera historike e deklaruar në pasqyrat financiare, me diferenca në (**mungesë**) në gjendjen fizike sipas fletë inventarit ku; llog.(32) shuma **269,862 lekë**, e cila përfaqëson libra dhe nga komisione sipas

PV datë 29.01.2021 janë nxjerre përgjegjësi dhe ngarkuar për shpërbllim dëmi personin përgjegjës z. E.M., sipas njoftim detyrimit nr. 487, datë 8.2.2021, por që akoma nuk është zhveshur nga vlera kontabël e llog. 327, e cila lihet detyrë për pasqyrat financiare të vitit 2021.

- Sipas relacionit të komisionit të inventarizimit për Kryetarin e Bashkisë Kuçovë me datë 05.02.2021, janë propozuar për dalje jashtë përdorimit vlera 9,744,388 lekë të bashkisë qendër dhe vlera 308,600 lekë e njësisë vartëse "Qendra Kulturore "Fenikes", respektivisht:

a- Bashkia Kuçovë

Nr.	Institucioni	Totali	Llog.214	Llog.218	Llog.327
1	Njësia Kuçovë	4,491,975	151,500	3,495,238	845,237
2	Njësia Kozares	906,854	188,000	596,266	122,588
3	Njësia Perondies	2,453,650	156,500	1,751,797	573,953
4	Njësia Lumanas	186,420		17,120	15,300
5	Parku i MNZHS	1,676,889	246,200		1,430,689

b- Njësisë vartëse "Qendra Kulturore "Fenikes"

Llogaria 327 në shumën 66,270 lekë

Llogaria 214 në shumën 4,500 lekë;

Llogaria 218 në shumën 237,830 lekë

Me urdhër nr. 24, datë 04.02.2021 të Kryetarit të Bashkisë Kuçovë është ngritur komisioni për vlerësimin e aktiveve të propozuara për dalje jashtë përdorimit.

Me urdhër nr. 25, datë 04.02.2021 të Kryetarit të Bashkisë Kuçovë është ngritur komisioni për asgjësimin e materialeve të propozuara për dalje jashtë përdorimit.

Me shkresën datë 13.03.2021, Drejtoria e Financës i është drejtuar Kryetarit të Bashkisë për miratimin e procedurës për dalje jashtë përdorimit.

Me vendim nr. 5, datë 25.03.2021, Kryetari i Bashkisë ka miratuar procedurën për dalje jashtë përdorimit, duke ngarkuar për zbatim Drejtorinë e Financës dhe Buxhet.

Nga Drejtoria e Financës/ Buxhet me shkresën nr. 1183, datë 01.04.2021 i është kërkuar Drejtorisë Juridike, që një pjesë e materialeve të kalojnë për rishitje alumin 106 kg, bateri makine e tjera 223 kg dhe hekur 871 kg. **Nga kjo e fundit nuk është ndjekur asnjë procedurë deri në datën e mbajtjes së aktit.**

Me shkresën nr. 1899, datë 02.06.2021, Kryetari i Bashkisë i është drejtuar Këshillit Bashkiak për miratimin e listës për dalje jashtë përdorimit, material i cili akoma nuk është shqyrtuar.

Kriteri:

Veprime në mospërputhje me UMF nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu (IV) “Sistemi kontrollit periodik aktive”, pika 74 “Inventarizimi aktive”.

Ndikimi/Efekti: Pasaktësi në postet e pasqyrave financiare.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi:

- Bashkia Kuçovë, nëpërmjet Nënpunësit Zbatues të marrë masa për sistemin llog. 327, për diferencat e konstatuara sipas inventarë të kryer për vitin 2020, si dhe të ndjek të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës 269,862 lekë ndajë z. E.M., si personi përgjegjës për diferencën e konstatuar ndërmjet fizikut dhe kontablit.

- Kryetari i Bashkisë Kuçovë, në cilësinë e Nënpunësit Autorizues në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë e Financës/ Buxhet në cilësinë e Nënpunësit Zbatues, të marrin masa për zhvillimin e procedurave të ankandit për shitjen e materialeve të dala jashtë përdorimit, por të vlerësuara nga komisioni për rishitje.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2020, u konstatua se llogaria (466) “Kreditorë për mjete në ruajtje”, paraqitet vlera prej 15,882,787 lekë, e cila përfaqëson detyrimet që Bashkia Kuçovë ka ndaj subjekteve të ndryshme për garanci punimesh (5%), deri më 31.12.2020. Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se vlera prej 10,390,115 lekë për 13 subjekte, nuk u ka përfunduar afati i garancisë së punimeve. Ndërsa vlera prej 5,492,672 lekë për 19 subjekte, përfaqëson detyrime të bashkisë ndaj subjekteve, për garanci punimesh të kryera para vitit 2019, të cilave ju ka përfunduar afati i garancisë së punimeve (*të dhëna sipas pasqyrës Aneks 1, bashkëlidhur projekt raport auditimit*). Nga ana e Bashkisë Kuçovë, Drejtoria e Financës nuk është marrë asnjë masë për sistemin e kësaj llogarie për rastet ku afati i garancisë së punimeve ka përfunduar, veprime në kundërshtim me ligji nr. 68, datë 24.7.2017 “Për financat e Qeverisjes Vendore” dhe Udhëzimi nr. 8, datë 9.3.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme” (*Më hollësisht në faqen 16-37, të Raport Auditimit*).

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës/Buxhet Bashkia Kuçovë, të marrin masa për sistemimin e llogarisë (466) “Kreditorë për mjete në ruajtje”, për rastet kur garancia e punimeve ka përfunduar, duke bërë njoftimin e subjekteve për paraqitjen e dokumentacionit përkatës për kalimin e garancive, ose në rast mos paraqitje në bashkëpunim me Degën e Thesarit të shfrytëzohen të gjitha hapësirat ligjore për sistemin e kësaj llogari.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2021

2. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2020, u konstatua se llogaria. (468) “Debitorë të ndryshëm” e cila paraqitet në vlerën 167,809,137 lekë, përbëhet nga:

Emërtimi i llogarive	Vlera
Llogari (468)	
-Nga aludimi i KLSH	10,460,883
-Nga policia bashkiake	32,500
-Nga banesa të dhëna me qira	8,921,960
-Nga IVMT	31,850,000
-Nga Drejtoria e të Ardhurave	116,280,962
-Te tjera	262,832
Totali	167,809,137

Në lidhje me detyrimet debitorë të mësipërme, Drejtoria e Financës me shkresën përcjellëse nr. 3549, datë 17.10.2018 i është drejtuar Drejtorisë Juridike për ndjekjen e procedurave në arkëtimin e tyre, por nga kjo e fundit nuk është vepruar duke i lënë në heshtje dhe rënduar ndër vite llogarinë, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” nenet 98-102, ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 21-33 dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 93 (*Më hollësisht në faqen 16-37, të Raport Auditimit*).

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës/Buxhet në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Drejtorinë e Taksave Vendore dhe Inspektoratin Vendore Mbrojtjes Territorit (IVMT), të marrin masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e detyrimeve debitorë në vlerën 167,809,137 lekë, të paraqitura në fund të periudhës

31.12.2020, kjo për të ulur nivelin e borxhit dhe rritur nivelin e të ardhurave të Bashkisë Kuçovë.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2021

3. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2020, u konstatua se llogaria (202), e cila paraqitet në shumën 17,152,484 lekë, përbëhet nga:

I.	Studime-Projekte	Shuma 2019
1	Studime dhe kërkime Perondi	2,534,904
2	Plani Përgjithshëm Vendor Perondi	549,019
3	Plani Përgjithshëm Vendor Bashkia Kuçovë	4,044,574
4	Të tjera studime dhe kërkime	225,898
5	Studime dhe kërkime të pa trupëzuara	597,389
6	Projekt për rikonstruksionin e rrugës Ure Vajguore-Kuçove	3,272,701
7	Projekt për rehabilitimin e parkut industrial	5,928,000
	Totali i llogarisë(202)	17,152,484

Nga të dhënat e investimeve, në totalin e llog 202- *Studime dhe kërkime*", nga 7 projekte që janë në këtë llogari ka përfunduar vetëm për një objekt, konkretisht "*Projekti për rikonstruksionin e rrugës "Ura Vajguore-Kuçovë"*". Nga Drejtoria e Financës nuk janë bërë përpjekje për sistemin e veprimit kontabël të llogarisë, duke ia bashkëngjitur vlerës së projektit. Sipas Drejt. Financës një veprim i tillë nuk është kryer pasi ky segment rrugorë nuk është aset i Bashkisë Kuçovë, por i Autoritetit Rrugorë Shqiptar, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*", UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme*" dhe UKM nr. 2, datë 08.05.2003 "*Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, shkronja (b) (*Më hollësisht në faqen 16-37, të Raport Auditmit*).

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa për sistemimin e llogarisë (202) "*Studime dhe kërkime*", duke bërë që në këtë llogari të paraqitet vetëm vlera e projekteve, për të cilat investimet e lidhura me to nuk kanë përfunduar. Për projektet të cilat kanë përfunduar, vlerat të kapitalizohet sipas objekteve përkatëse dhe regjistrohen në llogaritë përkatësisë, si pjesë e kostos totale të objektit.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2021

4. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2020, u konstatua se llogaria (26) "*Aktive afatgjata Financiare*", paraqitet me vlerë zero, vlerë e cila nuk qëndron, kjo pasi Bashkia Kuçovë në QKB paraqet aksione me 100% të Klubit të Futbollit "N...", e cila është aksionare me objekt "*Organizim i aktivitetit sportiv në fushën e futbollit*". Regjistri si klub në federatën Shqiptare të futbollit dhe në të gjitha llojet e aktiviteteve të futbollit". Bashkia Kuçovë është aksionere me vlerë 3,500,000 lekë. Kjo vlerë e kapitalit me 100% lekë/aksione pjesëmarrës të Bashkisë Kuçovë në "F..." sha, në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të pasqyrave financiare viti 2020, më konkretisht në llogarinë (26) "*Aktive afatgjata materiale*", veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*", Urdhrin e MF nr. 64, datë 22.7.2014 "*Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabiliteti të Përmisuar*", me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit nr. 5 "*Aktivitet afatgjata Materiale dhe Aktivitet afatgjata Jo materiale*", pika 55,56 dhe 57 (*Më hollësisht në faqen 16-37, të Raport Auditmit*).

4.1. Rekomandimi: Bashkia Kuçovë, nëpërmjet Nënpunësit Zbatues të marrë masa për sistemimin në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin e aksioneve tek

KF “N...” me vlerë 3,500,000 lekë, në debi të llog. 26 “*Pjesëmarrje në kapitalet e veta*” dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2021

5. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2020, u konstatua se nga përpunimi i të dhënave mbi llog (231), e cila paraqitet në shumën 129,876,824 lekë, u konstatua se për disa objekte megjithëse kanë përfunduar, nuk është bërë sistemi i tyre nga llog (231) në llogarinë (212), pasi objektet kanë përfunduar, *konkretisht:*

Nuk janë kryer veprime kontabël për sistemin llogarish nga llog (231) në llog (212), kjo për objektin “*Rruga Perondi – Lapardha faza I*”, objekti “*Rruga Perondi – Goraj*” dhe objekti “*Rikonstrukcion me rërë bituminoze*”

Gjithashtu evidentohet fakti se llogaria (467) “*Kreditor të ndryshëm*”, sipas analizës së bërë për disa nga objektet vlera e faturës kreditorë më 31.12.2020, kemi mos përputhje me faturës kreditore të paraqitur në fund të vitit me vlerë reale që duhet të ishte, *konkretisht:*

- Objekti “*Permiresim I banesave kom.varfera*”, me vlerë kontrate 27,709,197 lekë. Likuiduar deri datë 31.12.2020 shumë 22,667,357 lekë dhe diferenca pa likuiduar akoma për mungesë fondesh në shumën 5,041,840 lekë. Sipas analizës së pasqyrës së kreditorëve, ky objektet paraqitet për vlerën 1,073,982 lekë, pra me një diferencë më pak sipas analizës për vlerën **3,967,858 lekë**.

Nga auditimi u konstatua se detyrimet e raportuara në fund të vitit 2020 në vlerën 155,086,764 lekë (*të akumuluar*) dhe fondet e miratuara për shpenzime të këtij viti në vlerën 727,616,364 lekë. Kjo situatë tregon se Bashkia Kuçovë mund të konsiderohet me probleme financiare në fund të vitit ushtrimor 2020, pasi vlera e stokut të detyrimeve të papaguara ndaj palëve të treta është 21.3 %, pra mbi nivelin prej 15 % të shpenzimeve vjetore të miratuara. Nëse situata nuk një përmisim, bashkia mund të kalojë dhe në vështirësi financiare, ku stoku i detyrimeve të prapambetura mund të kalojë 25% e shpenzimeve vjetore të miratuara, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” dhe UKM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe neneve 55 dhe 56, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” (*Më hollësisht në faqen 16-37, të Raport Auditmit*).

5.1. Rekomandimi: Bashkia Kuçovë, nëpërmjet Nënpunësit Zbatues të marrë masa për:

- Sistemin në kontabilitet të llogarisë (231) në llogaritë (213) ose (213), sipas objekteve pasi një pjesë e tyre janë mbyllur dhe duhet të kapitalizohet në aktive afatgjata materiale.

- Të sistemohen diferencat e faturave gjendje në fund të vitit 2020 në llogarinë 467, për një paraqitje të saktë të faturave të palikujduara në fund të periudhave ushtrimore, kjo për shumën 3,967,858 lekë në objektin “*Permiresim I banesave kom.varfera*” .

- Të marrë masa për planifikimin e procedurave në raport me nivelin e të ardhurave të arkëtuara në fakt dhe fondeve të deleguara dhe të mos planifikohet procedura të tjera pa mundësuar likuidimin e detyrimeve të prapambetura, kjo për të shmangur fenomenin e rritjes së faturave të palikujduara në fund të periudhës ushtrimore si rezultat i mos realizmit të të ardhurave dhe për të shmangur problemet financiare që kjo njësi ka dhe vështirësinë financiare që pritet të futet, pasi stoku i detyrimeve të prapambetura mund të kalojë 25% e shpenzimeve vjetore të miratuara.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2021

6. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2020, u konstatua se nga **294** objekte inventari në ndërtesa e konstruksione të administruara llog.(212) pasuri e paluajtshme (*sasi e vlerë*) pjesa e konsiderueshme e tyre prej **251 prona (trajtuar analitikisht)**

nuk janë të regjistruara në kontabilitet dhe pasqyrat financiare në aktiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, pasi 206 objekte janë të trashëguara nga (ish/komunat) NJSH, ndërsa 45 objekte të trashëguara nga ish/Bashkia, të mbartura nga periudhat raportuese paraardhëse (viti 2015), sipas gjendjes kontabël dhe inventar, për të cilat nuk posedohet asnjë titull pronësie (*certifikatë, apo vërtetim*).

Gjithashtu, sipas të dhënave të Sektorit të Aseteve pranë Drejtorisë së PZHT, u konstatua se një pjesë e pronave janë regjistruar nga Bashkia Kuçovë në Drejtorinë rajoneve të ASHK Kuçovë, por pa vlerë. Kështu gjithsej janë regjistruar 210 prona por pa vlerë, gjë e cila vështirëson procesin e kontabilizimit në pasqyrat financiare si asetet të Bashkisë Kuçovë. Për rrjedhojë kontabilizimi i AAM, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur, veprime në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu (VI) “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme” dhe veprim në mospërputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me ndryshime, Kreu (III), pika 35 dhe Kreu (II), pika (16) (*Më hollësisht në faqen 16-37, të Raport Auditmit*).

6.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Kuçovë, nëpërmjet Sektorit të Aseteve pranë Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (DPZHT), të marrë masa që të përgatisë dosjet me dokumentacionin e nevojshëm për regjistrimin e pasurive të paregjistruara në Drejtorinë Rajonale ASHK Kuçovë të pasurive të paregjistruara, ndërsa Drejtoria e Financës të përlllogarisë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimit, burimet e financimit me qëllim marrjen sa më parë të titujve të pronësisë të pasurive të paluajtshme.

Kryetari i Bashkisë Kuçovë në cilësinë e Nënpunësit Autorizuar në bashkëpunim me Drejtorin e Financës në cilësinë e Nënpunësit Zbatues, të ndërmarr të gjitha procedurat ligjore për vlerësimin e aktiveve të cilat janë pjesë e inventarit AAGJ të bashkisë, të certifikuara në ASHK Kuçovë, por pa vlerë respektive, me qëllim paraqitjen e vlerës së këtyre aktiveve në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të njësisë publike vendore bashkia Kuçovë më 31.12.2021.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2021

7. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2020, u konstatua se vlera e AAM/JM të paraqitura në Pasqyrat e Pozicionit Financiar, nuk evidentojnë “*vlerën reale*” të tyre, pasi nga ana e Bashkisë Kuçovë nuk është ndërmarrë asnjë procedurë rivlerësimi ndaj tyre, bazuar në SKK (5) “Aktive afatgjata materiale e aktive jo materiale”, paragrafi “Trajtimet kontabël për aktive afatgjata materiale”, pika (23-32) “Modeli rivlerësimit”. Vlerat fillestare, apo kostot historike të këtyre aktiveve rezultojnë sipas çmimeve të blerjes, si dhe kosto të tjera të drejtpërdrejta në periudhat përkatëse të krijimit, të cilat referuar në gjendjen që pasqyron kontabiliteti llog.(212) “*Ndërtesa e konstruksione*” për 251 (294-43) objekte (*ndërtesa e konstruksione të ndryshme, etj*) me vlerë 0 (zero) lekë e cila ka sjellë një situatë që vlera e aktiveve të nënvlerësohet, në lidhje me vlerësimin e aktiveve.

Gjithashtu për asnjë nga periudhat që nga momenti i bashkimit të ish komunave në një bashki, nuk është kryer inventarizimi i asteve që Bashkia Kuçovë ka të regjistruara në pasqyrat financiare, gjë e cila bëhet me evidente nga bashkia me ish komunat dhe nuk dihet me saktë si gjendje fizike e tyre, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar , Kapitulli IV-Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, “Inventarizimi i aktiveve”.

UMF nr. 08, datë 09.03.2018: Kap.(IV) “Përgatitja dhe rregullat e plotësimit të pasqyrave financiare vjetore të konsoliduar”, pika (105) (*Më hollësisht në faqen 16-37, të Raport Auditmit*).

7.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Kuçovë në cilësinë e Nënpunësit Autorizues, të marrë masa të menjëhershme për të kryer procedurat ligjore të rivlerësimit të aktiveve afatgjata

materiale (*ndërtesa e konstruksione*), pasqyrimin e tyre në kontabilitet me vlerë reale historike (*referuar tregut*), si dhe kryerjen e veprimeve kontabël referuar rezultatit (*rritje/ulje rivlerësimi*), respektivisht në llogaritë përkatëse (21) “Aktive afatgjata materiale” e llog.(109) “Diferenca nga rivlerësimi”.

Të ngrejë një grup pune me specialit të fushës, për kryerjen e inventarizimit të asteve të Bashkisë Kuçovë, të paraqitura në pasqyrat financiare, mbi evidentimin e gjendjes së tyre në fakt dhe në rast mungesë të ndiqen procedurat ligjore për sistemin dhe nxjerrje përgjegjësie.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2021

8. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2020, u konstatua se Të dhënat në tabelë përmbledhëse të inventarizimit janë konstatuar, diferenca në administrimin e aktiveve, ndërmjet gjendjes fizike të inventarit fizik dhe gjendjes kontabël vlera historike e deklaruar në pasqyrat financiare, me diferenca në (*mungesë*) në gjendjen fizike sipas fletë inventarit ku; llog.(32) shuma **269,862 lekë**, e cila përfaqëson libra dhe nga komisione sipas PV datë 29.01.2021 janë nxjerre përgjegjësi dhe ngarkuar për shpërblim dëmi personin përgjegjës z. E.M., sipas njoftim detyrimit nr. 487, datë 8.2.2021, por që akoma nuk është zhveshur nga vlera kontabël e llog. 327, e cila lihet detyrë për pasqyrat financiare të vitit 2021, veprime në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.3.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*” dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, Kreu (IV) “*Sistemi kontrollit periodik aktive*”, pika 74 “*Inventarizimi aktive*” (Më hollësisht në faqen 16-37, të Raport Auditmit).

9.1. Rekomandimi: Bashkia Kuçovë, nëpërmjet Nënpunësit Zbatues të marrë masa për sistemin llog. 327, për diferencat e konstatuara sipas inventarë të kryer për vitin 2020, si dhe të ndjek të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës 269,862 lekë ndajë z. E.M., si personi përgjegjës për diferencën e konstatuar ndërmjet fizikut dhe kontablit.

8.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kuçovë, në cilësinë e Nënpunësit Autorizues në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë e Financë/ Buxhet në cilësinë e Nënpunësit Zbatues, të marrin masa për zhvillimin e procedurave të ankandit për shitjen e materialeve të dala jashtë përdorimit, por të vlerësuara nga komisioni për rishitje.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2021

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi Tematik.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT